



SHIKOJ.COM

# **AUTOBIOGRAFIA**

**1898-1899**

**Përkthyer**

**nga**

**JUP KASTRATI**

ISTORIA E LINDITHEM DHE  
E LINDENJAR

... Gramshitë ...  
... për ...  
... për ...  
... të ...  
... të ...  
... të ...  
... të ...  
... të ...  
... të ...  
... të ...  
... të ...  
... të ...

AUTOBIOGRAFI

1898-1899

**Botohet me shkurtime**

1974

88

JUP KARTRA

Linda më 29 nëntor 1814 në Maqë, koloni e vogël arbëreshe e Kalabrisë, e vendosur mbi një kodrinë të hapët, përballë detit Jon. Nëna ime, prej shtëpisë Braile, atëherë trashëgimtare e dy familjeve të vjetra, Avati e Sqiljizi, kishte lindur në koloninë e afërt Strigari. Stërgjyshërit e babait rridhnin, ndoshta nga njëfarë Pjetër Anton Rada prej Shqipërisë, për të cilin në arkivin e Venedikut të vitit 1300 ndodhet një kontratë për shitblerje me Dogjen. Njëfarë Pjetër Antoni është i pari i shtëpisë Rada. Këtë e gjejmë në librat e pagëzimit të Maqës, emër që nuk u zhduk për katër shekuj deri në ditët tona. Kapela e Radëve, që ka datën 1640, i kushtohet shën Antonit në kishën tonë amtare.

Të qenët e saj, me pak ndërprerje kohe, për tre shekuj, famulltarët e katundit, deri tek im atë dhe deri tek im vëlla; pra, me të drejtë mund ta quaj veten prej fisit levitik. Edhe fusha e emblemës së shtëpisë sonë është e bardhë, si e guelfëve.

Deri shtatë vjeç, larg syve të tim eti, u enda nëpër fshat, duke marrë me vete katundarë të vegjël, jetimë hajdutësh, në lojëra palikarësh. Vetëm një ngjarje e asaj moshe, që më duket fillimi i fatkeqësive, më mbeti

në mend. Gyshi im, bri të cilit rrija gjithmonë, një ditë, kur ishte i lirë, po çonte në një vend të thurur, jashtë katundit, pelën e vet të bardhë. Kur arrita te vendi, gjyshi çeli derën e gardhit. U ndodha përbri, sepse isha vonuar në ngjitje të asaj pëllëmbë gardhi. Mbi të mbështetej derëza e kopshtit. Pela futi në gojë kokën time dhe, pa e dëmtuar fare me dhëmbë, më nxori të paprekur brenda gardhit. Nëna jonë plakë, Adriana, thoshte se unë kisha lindur me këmishë.

Në prill të 1822 hyra në kolegjin arbëresh të Shën Adrianit. Im atë jepte mësim në klasën e parë të liceut. Natën flija me të. Në dhomën e studimit më ngacmonin sepse gati të gjithë ishin më të mëdhenj se unë. Rrija i brengosur edhe për arsye se isha i fundit i klasës. Nga italishtja nuk kuptoja asnjë fjalë dhe nuk mund ta mësoja kurrë atë që nuk kuptoja.

Në gusht, i sëmurë, shkova në shtëpi. Ethet më mbajtën gjithë dimrit. Në mars të 1823 u ktheva përsëri në kolegji. Ndenja kot, pa përfituar gjë. Kështu që, në fund të vitit, imzot Belushi, peshkop, kryetar i institutit, e këshilloi tim atë të më çonte në bujqësi. E këtë ma tha nëna në pushimet e vjeshtës. Plot gëzim ua kallzova fëmijëve katundarë, miqve të mi, duke u dhënë fjalën se do të bëhesha përsëri shok i tyre. Im atë kishte kërkuar të më linin në shkollë edhe një vit, sa për të më provuar.

Kështu, më 1824, u ktheva në shkollë. Në orët e pushimit më takoi të ulem afër një djali prej Kozence nga shtëpia Orlandi, bir i një avokati me emër e që, si italian, e kishin lënë mënjanë. Ai fjalosej me mua me qejf, pasi tani e kuptoja njëfarë soji italishten dhe e dëgjoja me vërejtje, kur më tregonte të bëmat e haj-

dutëve në Sile ose për festat e qytetit. Ai më dha të lexoj *Jetën e Ezopit e Mbretërit e Francës*. E, pastaj, i ndihmuar fshehtazi prej tij për të hyrë në gjimnaz, fillova ta marr veten në bisedime me shokë e të marr zemër. Atë vit më vdiq gjyshi. Më 1821 ai kishte ngulur në Maqë flamurin tringjyrësh. Kishte marrë anën e francezëve, prandaj shihej me sy të keq nga reaksioni. Armiqtë e tij i uronin dënimin me vdekje. Një kozentinas me pushtet, D. Diego, prej shtëpisë shumë fisnike Tarsia, që kishte djemtë për mësim në kolegjin arbëresh dhe dy më të mëdhenjtë nxënës të babait tim, ndërhyri që gjyshit çdo dënim t'i ndërrohej me banim të detyrueshëm në Kozencë. Ajri i rëndë e i lagështitur i qytetit ia mundi trupin e fortë si hekur, brenda dy vjetësh. Erdhi në shtëpi, me leje, i sëmurë. Vdiq 59 vjeç. As e pashë, as e qava.

Vitin e ri shkollor përparova shumë. Në orët e studimit rrija në dhomë të tim eti. Prej Shën Mitrit vinte e pushonte Dhimitër Lopez, që ishte kushëri i babait. Ky ishte një djalosh me mendje të jashtëzakonshme. Kishte kryer studimet e liceut. Ndiqte si i jashtëm mësimet universitare të matematikës së lartë dhe të shkencave morale dhe të teologjisë, plotësoheshin atëherë planet mësimore të institutit tonë. Ai më shpjegonte, sikurse vitin e kaluar Gaspër Orlandi, fragmentet e dyshimta në latinishte e me shembullin e vet nuk më linte të ndërprisja studimin. Duke mësuar vazhdimisht, më shtohej besimi në veten. Gjeta librin *Jeruzalemi i çliruar* që u bë gjëja më e shenjtë për mua. Në orët e pushimit e të mësimet të greqishtes rrija gjithnjë me të në dorë, sado që nuk e kuptoja krejt. Gati fshehurazi, lexoja shumë libra të tjerë të autorëve italianë ose përkthime në

m. osha, e veshur në të zeza. Im atë e njohu dhe u ngrit për ta pritur.

— Jo, D. Mikel, nuk do të rri, por lermëni të njoh djalin tuaj, Jeronimin. — Ajo m'u hodh përsipër e më mbuloi me të puthura e me lot.

E ndoqa me sytë plot trishtim, kur zbriti në oborr, ku e priste një shërbëtore, e hipi mbi gomar e iku.

Im atë ma kishte kundërshtuar dëshirën, që zgjati, për t'u mbyllur në ndonjë manastir, derisa të mbaroja studimet e të mundja me mendje të arsimuar të vendosja për jetën time.

Që nga ky vit, si prej një banje në det të paanë, për shkak të një regjimi të përsosur, m'u përtëri shëndeti, m'u zgjerua mendja dhe m'u forcua shpirti me besim.

Në kolegji më dërguan tek ata të moshës së mesme, duke mos pasur me vete asnjërin prej shokëve. Në muajin e parë ndenja si i huaj, duke iu ruajtur talljeve të shokëve lidhur me vitin e kaluar, të cilit e ndieja se i kisha kthyer shpinën. Vetëm gjatë shëtitjes u njoha me një djalosh italian, afroheshim e shkëmbenim llafe. Ai ishte nga Rende, në rrethin e Kozencës, prej shtëpisë Xagareze, i lindur nga një bijë e baronit të Shën Donatit, me shpirt të pastër, të pafajshëm, të drejtë, sikurse dilet nga shtëpitë e thjeshta.

Ndodhi, pra, që një ditë të pushimeve të krishtilindjeve, i ulur afër mangallit me tre a katër shokë konviktorë, i kërkova njërit prej tyre një thikë për të qëruar një portokall; një prej tyre, që ishte dy vjet më i madh se unë, shumë i përpiktë në mësimet përmendësh, studionim në të njëjtën klasë, ia priti prej vendit të tij: «Mos ia jep!» Por ai ma dha thikën veçse fyerja më preku

shumë. Mbas kësaj ngjarjeje, një dëshirë e madhe më hyri në zemër: të vihesha në krye të fjetores sime. Ndodhi, pra, që në atë vit, nuk mbaj mend çfarë ngatërrese na ndau në dy palë: njëra, ajo e italianëve dhe e arbëreshëve të ritit latin, kurse tjetra e arbëreshëve të ritit grek. Në mbrëmjen e pashkëve, në dhomën e boshatisur nga bankat e mësimin, u kacafytëm me grushta. Në njërin isha unë dhe në tjetrën ishin dy djelmosha më se 16 vjeç. Fitoi ana jonë dhe ngriti trofeun mbi shtratin tim. Të hënën u bëmë përsëri shokë, e tryeza e paqës, ku ata të ritit latin na thirrën, u shtrua mbi shtratin e Xagarezes. Qysh prej kësaj kohe thirreshim me emrat e Orestit e të Piladit.

Kënaqësia ishte e madhe, si e ndiej sot vetë, por atëherë nuk më rrëmbeu shumë, gati sikur mos ta kuptoja. Isha i lumtur nga miqësia dhe, pastaj, spektator i pangopur, simpatik për kohën më të nderueshme, që pat jeta pranë popujve të ndryshëm, orë që na kanë mbetur të përshkruara prej artit të fjalës. Më tërhiqnin, sidomos, tragjeditë e Sofokliut e të Euripidit dhe, mbasi i lagia me lot personazhet e dashuritë e tyre, largohesha i pas-truar për miqësinë.

Ndër orët e lirshme, gjatë shëtitjeve, në hije pemësh e drizash, vetëm, lexonim ndonjë klasik italian o të përkthyer prej gjuhësh të tjera. Me kureshtje lexoja *Orlandin e Tërbuar* e me më përfitim *Korinën* e zonjës Stael. Vitin tjetër më pëlqente të lexoja Ciceronin: *De Officis*, traktatin e tij të miqësisë dhe *Jetën e shkruar* nga Middleton. Gjatë këtyre viteve synoja të formoja stilin, duke



pasur për model Petrarkën, gjuha e të cilit më dukej e mahnitshme. Nga ai studim nuk më mbet veçse gjurma e errësirës, e cila më dëmtoi më vonë shpesh në konceptet e mia.

Në nëntor të vitit 1831, i prirë nga emri i mirë që kisha fituar, më kaluan te mesatarët. I mbetur pa kundërshtarë në klasë, i ndarë prej shokëve, Domenik Mauros, Aleksandër Serembes, që në vend të vetmisë së Shën Adrianit kishin pëlqyer shkollat e qytetit, e ndjeva veten më të lirë për çdo mësim. Nuk kishte kurrfarë libri të ri, që të hynte në konvikt e të mos ma jepte për lexim çdo sallë studimi. Gjithmonë vazhdoja, përtej masës e pa mësues, të punoja për formimin e stilit, duke imituar, në mënyrë të ngatërrueshme, më të mirët dhe i pyesja mësuesit e stilistikës mbi qenësinë e së bukurës, që ata nuk e dinin, dhe mbi rregullat e paraqitjes, të cilat s'i kuptoja qartë nga mësimet e tyre. Kam dëgjuar të thonë se mendja, kur është drejtuar nga leximet e shumta, që janë në kundërshtim në mes tyre, dobësohet. Ndoshta kjo ngjet kur mendja kërkon të zbatojë diçka edhe ndalet. Ndërsa më mbeste në mend ajo që më pëlqente, tjetra kalonte pa u kthyer më.

Mendoj se më ka vlejtur shumë të mësuarit përmendsh që kam bërë atë vit, të disa pjesëve shumë të bukura të Tasos, të Ariostos, të Iliadës, të përkthyer nga Monti, të një libri të Gjeorgjikëve, të Olimpiadës së Metastazios, të Varreve të Foskolos, etj. Në vitin tjetër munda të fusja në dorë *Korsarin* e Bajronit, që, bashkë me Alfierin, ishte çuar në qiell. Mua më bëri përshtypje të veçantë për risinë dhe madhështinë e figurave, por më dukej i shkollës së Lukanit, që nuk di të nxjerrë si të

gjalla, nga veprimet dhe nga të thënat, tiparet e njerëzve, porse përpiqet t'i sajojë duke përshtatur e duke i grumbulluar veçoritë.

Në të njëjtin vit, më 1832, tashmë në sallën e studimit të të mëdhenjve, iu vura punës për të hartuar një poemth me katër këngë, *Odiseu*, një temë shqiptare, duke përdorur rimën treshe; nuk mbaj mend, nëse i frymëzuar prej Dantes apo prej *Basvillianës së Montit*. Asnjë nxënës i kolegjit nuk ka qenë orvatur, më përpara, për t'ia hyrë një vepre të tillë. Për këtë arsye, ajo moshë jona, në të cilën libra të tjerë, veç atyre shkollorë, përmbytën kolegjin, qe koha e lulëzimit më të madh të tij. Vitin tjetër (në marsin e të cilit vdiq peshkop Belushi), e lashë shoqërinë, të rregulluar, thuajse si akademi. Çdo të shtunë secili lexonte ndonjë punim të vetin. Këtu i bëri provat e para shoku im fatkeq. Ëngjëll Bazile nga Plataçi, autor i veprës *Ines de Castro*, botuar në Napoli më 1848.

Ajo që do të përbëjë, ndoshta, një veçori të mendjes sime, qe pasioni që m'u zhvillua për matematikën, një dëshirë jo më pak e zjarrtë sesa për letërsi. Vazhdimisht, për dy vjet, letrat e mia nga njëra anë rrinin të shkruara me vargje, nga ana tjetër të mbuluara me figura gjeometrike dhe me shifra algjebrike. Arrita të nxjerr me mend rrënjën katrore të 24 numrave. Ishte profesor në kolegji Gaetano Çerri nga Marturano, që kishte pasë dhënë mësim në Nunciatela të Napolit e, mbas vitit 1821, qe i detyruar ta lërë katedrën. E mbaj mend se në klasën tonë, mbas kursit të *gjeometrisë plane* të Euklidit dhe të asaj të ngurtë, paraqitur nga Flauti, na dha në dorë *leksionet konike* të Karavelit, mik i tij. Ato

lidheshin me kurset e mëparshme të të njëjtit autor. Ne nuk i njihnim prandaj nuk mundëm t'i kuptonim. Në nëntor të vitit 1832, plaku i nderuar, pothuajse i dëshpëruar, më thirri në dërrasë të zezë dhe, mbasi e shpjegoi gjerë dhe qartë, si mjeshtër që ishte, fjalinë, nguli këmbë ta përsërisja edhe unë. E përsërita me disa pasaktësi të vogla. Ai më qortonte. E shkrova pastaj pastër në sallën e studimit dhe ua kalova shokëve.

Kështu, radhaz, studiuam lëndën deri në fund. Mbas gati pesë vjetësh më ishin zhdukur nga kujtesa ato njohuri. Ndoshta, mbasi u ushqye arsyeja e mendjes sime, nuk kishim më se ç'të bënim në të.

Në korrik të vitit 1833 e lashë kolegjin, i kënaqur me të kaluarën e pa kurrfarë pikësynimi o mendimi për të ardhmën. Që ta nxirrja veten prej lodhjes së kaluar dhe që t'u jepja, si me një ugur, mbas jetës bujqësore, babai desh që një vit të rrija për pushim në shtëpi e të kujdesesha për punët e familjes. Në shtator më erdhi prej Kozencës letra e avokatit të përmendur Rafael Valentini, i cili, më vonë, në moshë të shtyrë, u bë kryetar i pushtetit ekzekutiv të kryengritësve të Kalabrisë më 1848. Më kërkonte këngët popullore të kolonive tona. Shkova në Shën Kozmo te nënëdaja e këtu, një plakë, me emrin Tortoshëlja, më recitoi të parat këngë, ndërmjet të cilave ato të Dedë Skurës, Milo Shinit e Radavanit. Në Shën Mitër pata pjesët e shumë këngëve nga Oricia, gjyshja nëntëdhjetëvjeçare e Dhimitër Strigarit.

Pastaj vazhdoja të dëgjoja gratë e fshatit, prej të cilave mësova këngë të tjera. Mbledhjen e dërgova në Kozencë. Nga shoqëria me vajzat dhe nga thjeshtësia

e shqiptimit të atyre këngëve lindi historia e parashtrimiti i legjendës së Milosaos.

Një mëngjes u ndala me një shok të kolegjit te dera e hambarit të tij. Brenda gratë zgjidhnin misrin. Vura re një vajzë të re, rreth 23 vjeç. E ndiente veten të kënaqur se u ndodh me mua. Binte në sy si sjellje dhe m'ungul në zemër. Më vonë munda ta shoh shpesh, sepse ishte e bija e çobanit të grigjës sonë dhe ndihmonte gratë në punët e tokës. Ishim të druajtur dhe vetëm për vetëm nuk rrinim kurrë. Ndër ne, çdo takim ndërmjet dy seksëve ia humb stimën. Gëzimi i çdo dite ishte të shiheshim rishtazi. Këtu zuri fill studimi i gjuhës amtare. Për dy orë e gjysmë, çdo mbrëmje, ndërsa ndihmoja në studimin e latinishtes vëllanë, Kamilin, duke u ushtruar në ligjëratën e Ciceronit *pro Milone*, përpiqesha t'ia përshtatja shqipes masat e vargjeve greke e latine. Nuk pata asnjë arritje. Gjithmonë mbetesha pezull nga thjeshtësia e idesë dhe e trajtës së këngëve tona kombëtare.

Mbas katër muaj provash, në mëngjesin e Ujit të Bekuar të vitit 1834, hartova me mend idilin *Ish e diela menat* (Ishte e diela mëngjes), duke vënë një ngjarje timen të atij mëngjesi. U mbështeta në artin grek, që reflekton të vërtetën, në të cilin e rëndomta me idealen shkojnë bashkë.

Qysh atëherë ndoqa të njëjtën mënyrë, vizatova çaste të tjera të këndshme të asaj dashurie, duke imituar me sa mundja thjeshtësinë e Rapsodive; e me këto populli mblodhi e bëri të veta shumë aso këngësh. E mbylla serinë me tablonë «*Pra që dielli i ra te shtrati*» (Mbasi dielli i ra te shtrati) që e hartova në rrugë për Napoli, më 24 nëntor 1834, sikurse dhe të parën, duke udhëtuar

në karrocë. Të bashkuara ato përbëjnë «Këngët e Milosaos».

Më 1 dhjetor 1834 isha në Napoli, në shtëpinë e një fiorentini, D. Gjovani Rastrelí, nëpunës në bamirësinë e arsyeshme. Më pranoi në pension në familje dhe më dha dorë në jetën qytetare. Aty bëra shok djalin e vetëm të Paskal Rosit nga Tesano, (me të cilin ishte i një fisi gruaja e Rastrelit, zonja Rozina Travulo), dhe më deshën më shumë.

Në Napoli liria e tepruar në marrëdhënie në mes dy sekseve më la mbresa të këqija. I lindur në një shtëpi ku ishte turp të ulej në të njëjtin kuvend vasha e re dhe i fejuari, s'më pëlqente të shihja një djalë e një vajzë bashkë në tryezë, gjatë mbrëmjeve, duke u vështruar plot dëshirim. Në gji të këtij qyteti nuk dija nga t'ia mbaja më përpara. Për t'u zhytur në letërsinë moderne më dha dorë ajo pak frëngjishte që mësova brenda dy muajve nga leksionet e mikut tim bujar. Lexova më përpara Shekspirin, Shilerin, korrespondencën e tij me Gëten dhe *Revistën Gjermanike*, Kalderonin, vizatuesin e kalorësve të pakrahasueshëm dhe Teatrin frëng. Përshrypja që më bëri Shekspiri, për sa i takon stilit, nuk m'u hoq kurrë nga mendja. Ndjenjat e tij kaq të fuqishme më dukej se i shprehte mbasi i kishte bluar me vete.

Leximet e shumta, ndonëse pa metodë, si përherë ma tronditën shpirtin.

Në janar të 1836 shkova një mëngjes tek zyra e *Omnibusit*, gazetë letrare, e para që u pat themeluar në Napoli. Gjeta drejtorin, Vinçenc Torelin, vetëm në studio dhe i thashë kështu: «Kam disa këngë popullore, ndoshta do të jenë si diçka e re në gazetën tuaj». Duke

dëgjuar, ai u ngrit i përmalluar dhe, mbasi më shtrëngoi dorën, më tha: «Gjaku ynë i shprishur»! Ishte edhe ai arbëresh nga Barile në Bazilikatë. Omnibusi doli duke lajmëruar vizitën time dhe duke botuar poezitë, të cilat u dukën shumë origjinale. Dhe, më vonë, gjithmonë ajo qe e hapur për provat e mia.

Ky sukses më nxiti në studimet letrare. Fillova të përpunoj Odisenë, të cilën e kisha përpiluar në kolegji në rima treshe dhe po e parafragoza në vargje të zgjidhura. Në këtë kohë ndodhi që shokët më tërhoqën në shkollën e deklamimit të Emanuel Biderës, arbëresh ky prej Sicilisë, shumë i njohur në Napoli, dhe libretist i *Gemma di Virgy*. Por këtu, gjatë dy muajve, duke më penguar turpi, në vend që të deklamoja, recitoja me një monotoni të pagjallëri tingëllimin e Petrarkës: «*Më çoi mendimi im nga ajo anë ku ishte ajo që unë kërkoj, etj*» Aq sa profesori, mbasi tërhoqi mënjatë shokun dhe farefisin tim, Dhimitër Strigarin, nxënësin e tij të zgjedhur dhe sot avokat i dalluar i Napolit, i bëri të njohur hidhërimin për paaftësinë time. Por e meta, sikurse më dël sot në pah, pjesërisht ishte në vetë tingëllimin e pashije dhe të pafuqishëm jo për të ndezur tjetër gjë veç disa zjarre të kota në mendjet e rektorëve. Të dielën e ardhshme u ngrita dhe lexova, me pasionin që e kisha krijuar, një fragment të përpunimit në vargje të zgjidhura të Odisesë.

Profesori iu afrua bashkënxënësit Luigj Terci nga Paterno dhe e pyeti nëse ato vargje ishin të Bajronit. — «Jo, iu përgjigj miku im, janë të vetat». Plaku i nderuar atëherë zuri vend para meje, dhe, duke më vështruar me vëmendje, mbasi i nisi nxënësit, më mbajti pranë

vetes dhe dolëm së bashku. I dëftova për ushtrimet në gjuhën tonë, më dëgjoji ndonjë ode të *Milosaos* dhe nuk la arsyetim pa më bërë për të më bindur që t'i qitja në dritë. Më gjeti vetë shtypshkruesin, ndërsa unë rropatesha të më sillnin të hollat nga shtëpia për shtyp. U botua, në gusht të 1836, ajo këngë që ia kushtova mareshalit Dhimitër Leka, arbëresh edhe ky, po prej mëmëdheut. Kishte mbetur në Mbretërinë e Napolit mbasi u shpërnda regjimenti mbretëror maqedon, në të cilin kishte luftuar së bashku me Marko Boçarin.

Atë muaj kolera kishte pushtuar Napolin. Në tetor ika përsëri për në shtëpi, duke marrë me vete kopjet e poemit, që u vlerësua në mënyrë shumë të favorshëm.

Përpara se të kaloj përtej, do të bëj një shënim të spikatur të karakterit tim. Në atë verë do të jepja provimet në Universitetin e Napolit për *pustullën* në letërsi, duke depozituar në sekretari gjashtë dukatë. Mora 12 pikë në të gjitha lëndët, pra diplomën (*Laurën e lirë*). I kënaqur me vetveten, nuk u kujdesova më për të tërhequr depozitën, as për të nxjerrë *pustullën*.

U ktheva, pra, në vendin tim, ia nisa provës për të ngritur gjuhën tonë që të paraqitja mënyrën e jetës së lartë ndër krijime mundësisht të vërteta dhe me pasione fisnike. E kam çekur në historinë e Adines, hartuar në shtëpinë Rosi, në Tesano, afër Kozencës.

I vazhdova përpjekjet, më 1837, me *Nata e krisht-lindjeve, Frozina, Vantizana*. Por gjuha ishte, për mua, një vegël me shumë tela të këputur, dhe kjo përbënte për krijimet një gjendje të vështirë, potnuaj të pakalueshme. Nga Napoli ishte riatdhesuar në Shën Mitër Domenik Mauro. Dhe, mbasi e lamë çdo rivalitet, çdo

të enjte ndanim rrugën duke dhënë detyrën e javës. Në atë vit ai përpiloi poemën e vet *Enriku*.

Në fillim të qershorit më erdhi një letër ekspres prej Kozence, që më urdhëronte të merresha vesh me të përbetuarit e Specanos Arbëreshe e të Kastrovilarit, bashkë edhe me ata të Akrit e të Longobukos; të njihja forcat që kishin, t'ua kumtoja dhe t'i rreshtoja e t'i përgatitja. Shkrova një letër për Akri dhe shkova vetë në Specano. Mbasi ishte e diel, zbritëm në Kameratë. Këtu u grumbulluan nga Kastrovilari e nga Kasano shtatë ose tetë studentë të diplomuar, të plogësht, nga të cilët asnjëri s'm'u duk se mund të kishte edhe një njeri të vetëm. Njëri prej tyre kishte prurë një kitarë dhe i binte. I prekur, nga muzgu, ia hipa edhe një herë kalit dhe miqtë e Specanos nuk ia dolën të më ndalnin. Mbrëmjes vonë ia beha në shtëpi, i dëftova çdo gjë tim, eti dhe i shpreha vendimin për t'u shkruar që ata të mos kishin më shpresë tek unë. Përgatita relacionin dhe korrierin për të mërkurën në mëngjes kur, ja, në mbrëmjen e së martës arriti nga Kozenca një lajmëtar me urdhrin e komitetit të Napolit: «Të binim në Kozencë, më 22 qershor, ditë e caktuar për revolucionin e të gjitha krahinave». Nuk mund të tërhiqesha më pa humbur ndërin. E kisha të qartë përfshirjen e njerëzve që po përgatishnin lëvizje bandash. As vetë nuk i dinin se ku ishin.

Menjëherë u dërgova të interesuarve qarkoren. Nga Specanoja u kthye me lajmin se katër nga ata më me influencë, të cilët kishin ardhur prej Kamerate dhe kishin qëndruar, atë mbrëmje, në kafene, kishin vdekur prej kolerës, së cilës do t'i ketë hapur rrugë malarja e Kameradës dhe gostia e ditës. Në kaq u tha se qerë



helmuar. Dhe kafexhiu, një italian i shkretë, mbas dy javëve që mbytur me thika. Prej Akrit, Tomazo Parvolo, kryetar i të pakënaqurve të Akrit e të Longobukos, m'u përgjegj se njerëzit ishin shpërndarë për korrje. Prej 300 të shkruarve në listë, vetëm 50 do të mblidheshin me ne te lumi Mokone.

Më 19 qershor dërgova një njeri në Tesano tek Paskal Rosi, që të dinte si ishin punët e të më këshillonte. Po korrieri nuk u kthye, kështu që, në mbrëmjen e 21 qershorit, mbasi mora bekimin e tim eti, u nisa me një dhjetë vetë të armatosur. Në orën 5 të natës arritëm në të djathtë të Mokones, u ndalëm. Sipas marrëveshjes me Akritin, qitëm njëherë me pushkë. Ndenjëm pak dhe e përsëritëm dy herë. Po kurrkush s'u përgjegj. Vazhduam përtej, me kujdes, deri në Krati. Kur zbardhi drita, duke u tërhequr, hymë në një kasolle trapaxhinjsh, në atë kohë e braktisur, sepse lumi kishte pak ujë. Prej këndeje dërgova një lajmëtar drejt Kozencës. S'kaloi shumë kohë dhe njohëm, në rrugë, njërinë që po kthehej nga Tesano dhe po sillte këshillën që të shpëtonim vetë. U kthye edhe lajmëtari që pat shkuar në Kozencë, ku çdo gjë e kishte gjetur në qetësi.

Dëgjuam se në të njëjtën ditë, pak larg prej nesh, nga e majta e Kratit, rrinte Gjovani Moshari me njëzet bashkatdhetarë të vet të Shën Benedetos. Pra vetëm dy arbëreshë kishin dalë në fushën e rrezikut.

Në perëndim të diellit grupi im u kthye në fshat, duke marrë nga Montanja dela Noçe dhe nga malet e Akrit. Nga ora 2 e mëngjesit hyra në shtëpi dhe rashë në gjumë.

Mbas një jave u përhap lajmi se gjeneral De Liguori

kishte qenë në Kozencë me *Alter Ego* dhe filluan nga të gjitha anët ti dërgonin paditjet, si nga keqbërës, si nga iakmues të bukës së qeverisë. Natën nuk shkoja në shtëpi. Ditën, kur nga larg dukeshin xhandarët, çdo grua e fshatit ishte për mua një rojë që vinte e më lajmëronte. Në fillim të gushtit u shpall dënimi me vdekje dhe ekzekutimi i njëmbëdhjetë vetëve nga shtëpitë e Kozencës, fajtorë për komplot kundër shtetit. Shumë i turbulluar, babai më gjeti në vendbanimin në *Via dele Arene* (Rruga e Zhurit) tek po lexoja në *Vademecumin* tim të asaj stine Frederik Shlegelin dhe më lajmëroi për këtë ngjarje të rëndë.

Në korrik, në trazirat e para, ndërsa ishin mbledhur në Shën Mitër krerët në preturë, dikush propozoi të merreshin masa sigurimi nga ana e zyrës, për shkak të lëvizjes kriminale që ishte zhvilluar në krahinën e Maqës. Kundërshtoi, megjithëse armik i tim eti, D. Salvator Marini, njeri me rëndësi, i cili kishte qenë, për dhjetë vjet, kryegjykatës në Monteleone dhe kishte autoritet më tepër se të gjithë. Ai vuri në dukje se unë isha i matur, po njëkohësisht edhe kokëkrisur, me një natyrë që u nënshtrohesha pasioneve. Po të nxirresha jashtë ligjit, siç mund të nxirresha, ndoshta dhe i nxitur nga njerëz të dëshpëruar, që kishin po këtë fat dhe që s'i përmbante gjë, mund të përsërisja në komunë krimet e cubave. Dhe, për më tepër, derisa të mos bënte kush ankesë pranë autoritetit për këtë fakt, heshtja nuk do të thoshte faj. Këto gjykime i pranoi gjykatësi De Simoni, mik i familjes sonë, dhe nuk u bë gjë.

Nga Akri u ngrit një padi kundër Tomazo Parvolos, si kryetar i të përbetuarve. Isha shënuar aty si bashkë-

fajtor kryesor. Por në prefekturë ishte D. Gjenaro Bafa, arbëresh me origjinë e kunat i Parvolos. Për krisht-lindje e pashkë bënte dhurata, prandaj denoncimi nuk vajti në prefekturë. Iu paraqit zotëri Bafës e u harrua.

Së fundi, një denoncim kësisoji në Specano iu drejtua prefekturës së vendit. Aty cilësoheshin me emër pjesëmarrësit në tubimet revolucionare të Kameratës dhe përmendeshin ligjëratat e tyre. Kryegjykatësi Vizantis i kishte dhënë të vetmen vajzë që kishte familjes së Frashinëvet të Firmos. Ata ishin të lidhur me mua me një dashuri të madhe që në kolegji. Nga kjo familje kishte marrë «Këngëi e Milosaos. E mori letërankesën dhe e dogji. I tha, pastaj, mikut tim Akil Frashinit: «Nuk ishte mirë për mua të filloja procesin kundër të vdekurve. Nuk do të veproja kurrë kundër Jeronim de Radës.»

Në këto ngjarje nuk mora pjesë fare. Një dorë e jashtme i zhvilloi, pa dijeninë time dhe vetëm hija e saj u ndal duke u pasqyruar paksa në pellgun e zemrës, por duke ia ndrydhur çdo frikë. Ditën qëndroja jashtë; vetëm të dielave merrja pjesë në mënyrë mekanike në meshë. Kolera ishte përhapur përsëri atë vit në krahinë. I mbyllëm të dyja daljet e Maqës me rojë. Deri në orën tre të natës, ndriçuar nga zjarre të mëdha, në çdo vend, aty afër, dhe në dritë ndër sheshe vallëzonin burra të rinj me gra të reja. Kur merrnin fund dëfrimet, humbisja nëpër kopshtet o në pyje që rrethonin vendin. Më zinte gjumi mbi armët, nën vështrimin e yjeve. Në netët me shi futesha në ndonjë kasolle vreshtash e në ndonjë kashtore për buaj, por gjithnjë duke ndërruar vend. Maqa mbeti e paprekur nga kolera, ndërsa dy fshatrat fqinjë,

Shën Mitri e Shën Kozmo, u shkatërruan. Mbas gjashtë muajsh natën e krishtlindjeve u ktheva në shtëpi dhe fjeta në shtrat. Atë vit nuk pata guxim të shkoja prapë në Napoli.

Dy vjetët që qëndrova në vendlindje më forcuan shpirtin dhe trupin. E kaloj kohën me ushtrime fushore, pa e vrarë mendjen për administrimin e shtëpisë. Kënaqesha me punën e lirë në ajër të hapët. Shtëpia kishte pasur nevojë gjithmonë për babanë. Ai e mori vonë në dorë mbarështrimin e saj, sepse gjithmonë ishte i zënë me punët e kishës dhe të Maqës së vet, që fqinjët, duke qenë i vogël dhe i varfër, kishin dashur gjithnjë ta nënshtonin. Lexonte e shkruante ai përherë. Kënaqej që studimi e kompozimi ishte për të një shmanjie e vazhdueshme nga jeta. Në atë vit pushimi pa mendime, me orë të tëra im vëlla, Kamili, duke nxjerrë nga zumaret kombëtare arie shqiptare, na ngrinte – si të thuash – shpirtin në qiell. Të asaj kohe janë vegimet e lira: *Anamaria Kominiate, O Agata, Diana Nasta, Vide-laide*: Ato nuk ishin kurrë simbol i ndonjë ideje të pararenduar, por përfytyrime të thjeshta gjërash, dhe nuk shquheshin për thellësi pasionesh.

Në verën e vitit 1838 vdiq, mbas dy vjetësh martese gruaja e vëllait tim, e Kostandinit. Na u desh t'i kthenim pajën babait të saj, D. Gjovani Bafës, kryepriфт i Shën Mitrit. Pak fryt që dhanë tokat e grigjat u harxhua për të mbuluar shpenzimet e paparashikuara për kohët e kaluara të djalërisë sime. Nuk më vinte keq edhe pse pakësoheshin mjetet e kthimit në kryeqytet, cak, siç më dukej, i jetës sime.

1898

## II

Në nëntor të vitit 1838 u nisa për në Napoli. Kisha një rekomandim të Rafael Anastazios për Benedikt Muzolinon, përfaqësues i Maxinit në qarkun e Napolit. Ky, ndoshta i paralajmëruar, më doli përpara i shoqëruar prej dy shokëve të mi të banimit, Akil Frashinit e Dhimitër Strigarit. Kështu që s'pata nevojë t'i dorëzoj letrën që mbeti në fund të baules. Pas ndonjë jave shkova te Zef Epiani, nëpunës pranë Ministrisë së Ekleziastikëve, i cili më paraqiti te Rafael Konforti, që më priti në zyrën e studios së vet.

Ky ishte një avokat penalist i zoti, në moshën ndërmjet 30 e 40 vjetësh, me një mendje të hollë e me njëfarë kulture letrare, që, ndër ato kohëra, ishte një gjë e rrallë në rrethin e tij. Brenda pak kohe më dalloi prej të tjerëve dhe tregoi besim të plotë tek unë. Në atë dimër shpirtin ma kishin pushtuar dy fantazma: lëvdata që iu thur poezisë, që kish gufuar nga thellësitë e shpirtit tim, dhe revolucioni, mbas të cilit më dukej se qëndronte një e ardhshme lumturish të pafund.

Shpejt njoha ambiciet e marrëzinë e Maxinit e të shokëve të tij. Në këtë kohë isha i magjepsur nga vegimi i lirisë greke e romake, saqë ishte e pamundur të mos më dukej arbitrare dhe shtypëse çdo monarki absolute. E shpirti im ishte aq i dhënë mbas kushtetutës, saqë,

në një mëngjes të prillit të atij viti, Emanuel Bedera, që ma donte gjithmonë të mirën, më qortoi seriozisht, ndërsa isha në kartolerinë e Fabrisit: «Po ti, De Rada, – m'u drejtua – që pate një zot që të flet në shpirt, si bashkohesh me njerëz të cilët nuk kanë me çfarë të rrojnë e përgatisin kryengritje për të futur në dorë atë gjë që thonë se është e popullit?».

Ndër këto dy vjetë, deri në tetor 1840, përveç detyrimeve të mia e drejtova shpirtin lirisht e pa kurrfarë kujdesi e gjithmonë aty ku kam dashur. Ndërmora botimin e veprës sime *Serafina Topia* e bashkëpunojta, krahas me këtë, në redaktimin e së përkohshmes *Viagjatore* (Udhëtari), e përkohshme kjo e themeluar prej Domenik Mauros. Merresha edhe me dosjet që më kalonte Konforti. Përveç mëngjesëve, e shihja gati çdo mbrëmje në Molo. Shëtisnim së bashku, duke biseduar me interesim të thellë për gjendjen politike të Evropës, e sidomos, për luftën e Spanjës. Fletët e *Serafinës*, të cilat nxënësit ia patën shpënë Malpikas, poet dhe improvizator i ditës, i bënë këtij një përshtypje të çuditshme. «Janë, – tha, – parashtrime të realitetit të gjallë, por jo poezi, sepse nuk ka në to asnjë gjurmë klasicizmi». Me vështirësi të madhe kisha marrë prej Revizorit Kanonik shënimin: «Të shtypet, për çdo fletë». Por, kur ia çova, dhe e lexoi veprën për të thënë: Të botohet, nuk desh, sepse, – tha, – «Këtu është një qiri i ndezur për Jezu Krishtin e një tjetër për djallin». Dyshonte, ndoshta, për *Idrinë*. Asgjë nuk mund t'ia ndërronte mendjen, megjithëse ai ishte një burrë i moçëm dhe i mirë. Mua më shkaktoi një dëm prej 70 dukatësh.

Mbas pak kohe e ndaloi botimin edhe *il Viagjatore*

(Udhëtari) e Domenik Mauros. Bashkë me ne edhe Vincenc Padule nga Akri botonte vjershat e para të vetat, me një stil të bukur. Të tre ishim shumë të rinj e moshajonë e re i jepte edhe vulën e vet së përkohshmes. Punë kjo që ishte me dobi. Ajo u përhap në të gjithë krahinën e Kozencës dhe e lexonin ndër shumë kafene të Napolit. Po kursimet studenteske, me të cilat mbahej, mbaruan përpara se të bëhej vjelja e pajtimeve dhe, kështu, ajo pati një jetë të shkurtër.

Në Napoli, ndër ato kohëra, ishte në rendin e ditës filozofia e Kondijakut. Prej saj më largonte besimi i krishterë dhe mendjeqartësia ime e natyrshme. Nga ana tjetër, meqenëse studimet e mia metafizike kishin qenë të pakta, për çështjet boshe, që përsëriteshin, tërhiqesha i mërzitur. Me një mendjehetësi me të vërtetë fodushe, të gjithë ata që simpatizojnë filozofinë e Kondijakut, nuk marrin parasysh, thuajse fare, traditën historike. Nga evolucioni i pandërprerë, nëpër të cilin kalojnë speciet, krijojnë konceptin për mosqenien dhe, me të arritur këtu, tek mosqenia, e flejnë mendjen. Pra, nuk e ndiejnë përshtypjen e keqe që duhet të shoqëronte atë anë të jetës njerëzore që shpenzohet gjithkund pas punëve, të cilat i merr mbrapa gjithmonë. Tashti, sipas tyre, pushojnë e humbasin me frytin e tyre, por njerëzimi, si valët e pandërgjegjshme të detit, ndjek aty vetveten pa pasur ndërgjegjen e ndonjë fati të vet.

Toka e Maqës, nga veriu, kufizohet me feudin e dukës së Koriljanos, në lagjen *Koste mançine*, marrë me qira, atëherë, prej zotëruesve të Akrit. Kishte filluar korrja e elbit e qetë e bashkëvendasve të mi, që nuk kishin qenë të ruajtura, hynë në pjesën e tokave të dukës.

Pasë njerëz të armatosur, nga rojtarët e qiramarrësit e feudalit, i sekuestruan e po i dërgonin kah Koriljanoja. Nganë shpejt të zotët e qeve për t'ua marrë. Mbas fjalëve që u bënë, vëllai im, Kamili, nëntëmbëdhjetëvjeçar, u lëshua kundër asaj çete. Teksa e panë se erdh, u ndez një grindje për që. Vëllai tjetër, më i madh në moshë, që kishte dalë për gjah në Kostë mançine, u hodh aty edhe ai me vrap. Dhe mbërriti aty, kur rojtarët kishin pasë shprazur armët dhe i kishin plagosur vëllanë me saçme në gjoks e ndër krahë. Atëherë zbrazi edhe ai armën e qëlloi njërin prej kundërshtarëve në fytyrë dhe e verboi. Pushoi të kacafyturit, duke marrë me vete bashkëvendësit e mi qetë e tyre e secila anë u largua me të plagosurin e vet.

Dy ditë më vonë, togeri i xhandarmërisë, Çiardi, që gjendej në Akri, zbriti me një sasi të armatosurish dhe na pushtoi shtëpinë. Ishte fare bosh. Përveç dados Andriana, që ishte aty për rojë, e motrës sime dymbëdhjetëvjeçare, nuk ndodhej askush. Ata bastisën shtëpinë e u larguan së andejmi duke sharë e duke kërcënuar.

Vëllezërit e mi u fshehën. Në korrik Kamili, që u padit për gjymtimin që shkaktoi, ra në duar të organeve policore. U dërgua në Qendrorin e Kozencës. Do t'ju tregoj një ngjarje që karakterizon vëllanë, Kamilin, i cili pati një jetë shumë të vështirë si gjithë shtresa e ulët e popullit kalabrez. Në të ashtuquajturat *Kampreze* të burgut të madh sundonte si në shtëpi të vet një i burgosur kokëkrisur, që kishte bërë një mijë e një të zeza, kur kishte qenë i lirë. Çdo i burgosur i ri ishte i detyruar t'i paguante njëfarë shumë në të holla, në donte të mos i binte në qafë. Im vëlla nuk pranoi



t'i jepte gjë. Prandaj ai dhe shokët e tij iu lëshuan në shpinë për ta paguar. Pa u mbyllur java, i dolën përpara, tek po hante bukë, dhe e provokuan. Nuk u foli, por siç ishte duke prerë bukën, u sul dhe e plagosi me thikë në gjoks kryetarin e keqbërësve. I gjakosur ua mbathi këmbëve gjatë rruginës së burgut mes brohoritjeve të të burgosurve të tjerë që përshëndetnin atë që e kishte plagosur. Atë mbrëmje fitimtarin e shpallën kryetar të Kamprezës.

Mbasi më patën shkruar për arrestimin e tij, Konforti u interesua pranë vjehrrës, e veja e juristit në zë Rafaeli. Kjo u interesua pranë prokurorit të përgjithshëm të Kozencës, Deziato Janigro, për një rekomandim. Deziato Janigro kishte qenë dikur në studion e të shoqit të saj dhe, që andej, pastaj kishte filluar karrierën e tij në magistraturë. Më parë se të ndodhnin këto, inspektori i përgjithshëm i Fanterisë, mareshali Leka, mbas kërkesës sime, e kishte transferuar togerin Çiardi, si fajtor për veprime arbitrare në Kotrone, ku vdiq nga malarja.

Nga mbarimi i korrikut erdhi në Napoli Rafael Mauro, vëllai i Domenikut. Shkova ta shoh e të marr vesh prej tij ndonjë lajm për njerëzit e mi, sepse, gjatë atij muaji, nuk më kishin shkruar. Kur pyeta, ai m'u përgjigj me vargun e rapsodive: «Në qoftë se do ta them, ti do të mërzitesh». Të gjithë e dinë se vëllai yt do të dënohet me njëzet vjet. Me çifligarët e Akrit është bashkuar kundër jush edhe Mark Madalene da Rende, që në Kozencë bën ç'të dojë. Vëllai yt, Kostandini, ra nga kali në rrugën e Koriljanos. Lëngon i sëmurë në shtëpinë e Akuilas, pranë vajzës me të cilën do të martohet. Yt atë, nga të

gjitha shqetësimet, e ka humbur pothuaj fare dritën e syve; dhe xhaxhai yt, prifti i Shën Kozmos, jep e merr i kapur nga të gjithë.

I mërzhitur zbrita atë mbrëmje në postë. Ishte e enjte. Gjeta një letër të Kamilit. Më pyeste në e kishin zënë dhimbjet e lindjes Regjinën edhe në kishte shpresë për ndonjë falje. Avokati Valentini (i cili kishte hequr dorë nga gjyqi prej kohësh, dhe kishte pranuar të merrte përsipër mbrojtjen e tij, vetëm për hir të miqësisë që e lidhte me mua) i kishte lënë të kalonin të pesë ditët pa kërkuar pafajësinë.

Kjo letër më turbulloi pa masë. U ngjita një vrap tek Konforti. Banonte atje afër, në *Shën Maria la Nova*. Megjithëse më dha shumë premtime, e ndoshta kishte mundësi edhe t'i mbante, brengën që kisha në shpirt nuk ma lehtësoi. U ktheva në shtëpi nga ora njëzet e katër. Kërkova një kandil dhe u vura të studioj. Çdo libër që hapja më dukej sikur nuk e kuptoja.

Të shtunën paradreke nuk m'u durua dhe u ktheva në postë, sado që e dija që në Kalabri posta vinte vetëm të enjten dhe të hënën. Por kishte disa muaj që vinte çdo të shtunë edhe një korrier qeveritar. U ktheva, pra, në postë, si pa dashur dhe pyeta. — «Po, — m'u përgjigjen, — ka ardhur për ju një letër, të cilën e ka sjellë korrieri «për hatër»». E hapa letrën dhe lexova: «Djembas mbrojtjes së D. Rafael Valentinit, që e la gojëhapur tërë auditorin, gjyqi të liroi vëllanë. Sot ndodhet në shtëpinë time; nesër do të niset me xhaxhanë tuaj për në Maqë».

1 gusht 1840.

Miku yt, Rozari Anastazio

Si e mora veten nga ky lajm i mirë, iu vura leximit të dy proceseve që më dha Konforti. Vura atje ato gjëra që mendoja se do t'i ndihmonin të pandehurit e i dërgova në shtyp. Kisha vendosur, aso kohe, të merresha me drejtësi.

Por, para se çështjet të shkonin në gjyq, një natë, andej nga ora dymbëdhjetë, disa drita fenerësh ma prishën gjumin. Banonim në një dhomë të gjerë me katër shtretër: dy vëllezërit Rafael dhe Gabriel Xagareze, Gjuzepe Konsole, që u bë, më vonë, këshilltar i Gjyqit të Lartë në Katancaro, dhe unë. Ishte zoti markez Kançelier i Gjuntës së Shtetit dhe sekretari i prefekturës së policisë, me një turmë policësh me drita dhe me armë. Pyetën për mua, u ngrita menjëherë. Më pyetën nëse e njihja njëfarë Benedikt Muzolino. «E nga është ky?» – u gjegja, gjoja sikur nuk e njihja. Po nuk folën më asnjë fjalë, shtuan vetëm se ministri kishte pak punë me mua. M'u desh t'i mbyllja shkrimet në baule dhe të shkoja me ta në prefekturë. Nga të dy anët e shkallëve qenë rreshta me xhandarë, kështu që thashë i habitur: *Venerunt ad me cum fustibus et lanternis* (Erdhën tek unë me shkopinj dhe me llamba).

Në prefekturë u shtriva në një kanape dhe vijova gjumin e ndërprerë. As e kuptova e as ma mori mendja rëndësinë që i jepej arrestimit tim. Atë vit kishin vënë dorë mbi *Italinë e Re*. Vëllezërit Muzolino, Rafael Anastazio dhe Setembrini qenë kapur e futur në burgun e Sh. Maria Aparentes. Prej Akrit i ishte dërguar qeverisë një grumbull me letra të kapura, me anë të së cilave unë i jepja lajme tim eti mbi aleancën katërpalëshe, etj. etj. Kisha filluar të bëhesha i njohur në qarqet e kryeqytetit.

Kishin, ndoshta, arsye të shpresonin se në letrat e mia do të gjenin ndonjë fill drite që u duhej.

Në mëngjes më morën në pyetje. U kontrolluan letrat. Inkuizitori Markeze, mbasi i lexonte, i hidhte të gjitha për dhé. Kur nxori nga të fundit, e pashë në dorë letrën e Anastazit, që kishte brenda rekomandimin për Muzolinon, kujtova se mbarova. Dhe ja, ndodh që, ndërsa inkuizitori përshkonte me sy letrën e Anastazit, në fund të së cilës ai kishte vënë emrin, por jo mbiemrin, letra tjetër e bashkangjitur me të shkau e ra poshtë mbi pirgun e atyre që dergjeshin për dhé. Më pyeti se kush ishte ky Rafael Mauro, për të cilin bëhej fjalë në letër. Iu përgjigja pa të keq. Dhe, ose ngaqë ndoshta kujtoi se ishte fjala për një Mauro dei Kazali, të cilin e kishte kumbar dhe që qe arratisur në Zvicër, që e mbante në dijeni mbi veprimtarinë e të mërguarve italianë të atjeshëm, ose ngaqë ishte i lodhur dhe punë të tjera, më të rëndësishme, e thërrisnin gjetiu, nuk u ul ta merrte letrën e rënë, po përshkoi me sy edhe ato pak letra që i kishin mbetur dhe më nxori jashtë.

Më kthyen në burg, në mesin e ditës. Shërbyesja më kishte sjellë drekën. Ma kishin dërguar shokët. Kjo vazhdoi tërë kohën që qëndrova në prefekturë. Mbas tri ditësh erdhi të më takojë vëllai i Konfortit dhe më solli 10 pjastra, që ia dhuronin autorit të kujtimeve dy klientë të tij të liruar. Kur kisha hyrë në burg, kisha pasur me vete vetëm gjashtë karlina.

Mbas një javë më çuan në Shën Maria Aparente, ma vunë shtratin bashkë me kozentinët Salfi, Stumbon dhe Milonen, që kishin qenë të përzier në kryengritjen e dështuar

të vitit 1839. Mbas disa ditësh erdhi atje edhe njëfarë Rugjero Kolonelo, një kalorës që zbriti i brohoritur. Ai, nuk e di nga se, tregoi se kishte njëfarë nderimi për mua. Njëpërmjet tij i dhashë një pjastër kryetarit-Kamorra, Kopola di Salernos, që ishte një mik i vet i vjetër, si shpërblim për shërbimet që do të na bënte në të ardhmen si gjellbërës i të burgosurve.

Ai që një muaj shumë i qetë dhe unë, në atë vend, që ngrihej mbi zhurmën e qytetit, mbi detin e hapur në të gjitha drejtimet, me një besim të madh s'di se ku, harrohesha mbas përfytyrimit të fundit tragjik të Astirit dhe të Gonetës si dhe mbas peripecive të Gjon Huniadit në burgun e Belgradit. Por sapo dielli arrinte në kupë të qiellit, kisha përshtypjen se më ngulej në kokë një gozhdë, që më shkaktonte një vuajtje kaq të madhe, sa që shtrihesha e përpëlitesha në shtrat, pa gjetur dot shërim.

Mbas një muaji më liruan prej burgut, por dhembja e kokës nuk pushoi veçse ngadalë jashtë. Si punë e parë, shkova në studion e Konfortit për të rifilluar profesionin tim legal. Mbas tri ditësh, ndërsa bëheshim gati që të shkonim së bashku në gjyq, hyri në studio një inspektor i policisë. Pyeti në ndodhesha atje. Kur i thashë se po, u largua. U kthye përsëri të hënën e javës tjetër. Të gjithë, sa qenë të pranishëm, u tronditën. Atë mbrëmje shkova te Konforti, e gjeta vetëm me zonjën dhe i thashë: «D. Rafaele, me sa duket nuk paskan më të drejtë të përfitoj nga mirësia juaj. Klientët mund të mendojnë, për fajin tim, se nuk shihen me sy të mirë nga qeveria dhe t'u largohen. Pra, më lejoni të largohem, ndonëse nga ju nuk do të ndahem kurrë. Xhandarët më kanë detyruar të gënjej dy herë deri tash kurse sot po

më pengojnë në karrierën time». Vura re se D. Angjelika, bashkëshortja e tij hirëplotë, u trondit shumë nga këto fjalë.

## 2

Nuk kisha, vërtet, ku të vija kryet. Mateo de Augustinis, një nga liberalët e parë të Napolit, i cili ishte duke botuar disa komente për kodin civil për të hapur në nëntor një shkollë, kur mori vesh si i kisha punët, më propozoi dhe nguli këmbë që ta hapnim shkollën bashkë: ai si mësues i së drejtës civile, unë si mësues i kodit penal. Nuk pranova, se nga ligjet penale dija vetëm nenet që më nevojiteshin në praktikë. Nga ana tjetër, nuk kisha pasur kurrë rast t'i flisja, në gjuhën italishte, një grumbulli dëgjuesish, dhe këto dy të meta ia dija vetes.

Isha shumë i sëmurë. Përveç rrugës pak të gjatë në pikën e diellit, më lodhnin edhe shkallët që ngjitja dhe një mëngjes vura re ca shenja gjaku në pështymë. Pata kujdes të mos e bëj fjalë me njeri e, veçanërisht, me tim atë. Lirimi im i kishte ngushëlluar disi dhe më 10 tetor mora rrogën e muajit. Në gjysmën e parë të tetorit erdhi në Napoli Çezar Marini, një bashkatdhetar, vëllai i D. Salvatores, një nga personat e nderuar të Shën Mitrit, që më kishte dhënë një ndihmë të madhe më 1837. Si avokat i parë i Kalabrisë, kryente në Kozencë punët e kalorësit D. Nikolla te markezi Spiriti, që pjesën më të madhe të pasurisë e kishte në Kalabri. Ky i fundit i qe lutur t'i gjente një mësues privat për të birin e vetëm njëmbëdhjetëvjeçar. Marini kish dëgjuar të flitej për mua edhe më njihte. Më propozoi. Kishte marrë përsipër të

më takonte dhe të bisedonte me mua. Pranova dhe shkova tek ai. U morëm vesh. Kështu, më 1 nëntor 1840, u ula në tryezën e tij duke qenë aty të pranishëm i biri dhe e shoqja, e bija e baronit Pasalakua, një grua ka-luar të dyzetat. Më 1839 u kishte vdekur në kolegjin e jezuitëve një djalë 14 vjeç. Një vajzë e rritur, që ishte fëmija i tyre i parë, ndodhej në kolegjin e Sh. Marçelinës. Atë mbrëmje kuvertat, çarçafët, dysheqet etj. të shtratit i ndava me shërbëtorët dhe shërbëtoret e shtë-pisë së re.

Krejt i shkujdesur për të ardhmen, iu kushtova i tëri kujdesjeve për nxënësin dhe përsosjes së vetes. Si i dehur nga dëshira për punë, nuk çaja kokën për së-mundjen. Ngrihesha në mëngjes në orën gjashtë, si më ishte bërë zakon gjatë kohës së gjatë që kisha qenë në kolegji, shkruaja derisa zgjohej familja. Pastaj filloja mësimet, të cilat i vazhdoja deri në orën 10,30', që ishte koha e sillës. Si kalonte një gjysmë ore, rifilloja më-simin. Kjo më dëmtonte. Nuk kisha studiuar kurrë me-njëherë pas buke, pa marrë një sy gjumë. Aty nga ora dy, dilnim shëtitje me karrocë dhe ktheheshim, kur zinte të ngrysej, për të ngrënë darkën. Po, kur ngriheshim nga tryeza, në rast se nuk shkonim në teatër, duke qenë i lirë, kthehesha përsëri në studimet e mia. Ato zgjatnin deri natën vonë. Ky çrregullim jo i zakonshëm për mua, duke mos ecur më vazhdimisht, të ushqyerit në orë të ndryshme dhe me ushqime të tjera, ma prishnin dita-ditës shëndetin. Herë pas here pështyja gjak. Mbasi studioja për një kohë të gjatë, bija në shtrat si i mpo-shtur nga ethet. Natën bëhesha qull në djersë. Mjeku që më vizitonte, më mori gjak tri herë gjatë muajit

aq sa, nga dobësia e madhe, m'u shpif një kollë, që s'më ndahej.

Në këtë gjendje më gjeti nata e së kremtes. Qull në djersë, me kokën e rëndë, me dhimbje në shpinë, më mposhti natën vonë një gjumë i lehtë si me përçartje, nga i cili më përmendën, mbas pak, kambanat që binin për festë nga të gjitha anët e Napolit. Bashkë me kambanat, vigjanezët u binin gajdeve përpara një grazhdi në bodrumin përposh dhomës sime të fjetjes.

Në mars kaluam në vilën Amoreta dhe këtu rrezet e para të diellit më goditnin në mëngjes nëpër ullishtat e kopshtet që mbanin erë lule portokalli. Pastaj, dy orë para mesditës, bridhja në kalë me nxënësin tim deri rrëzë Vezuvit. Mbasi ktheheshim, uleshim në tryezë për të ngrënë bukë. Mësimet në atë vend pushimi qenë pakësuar në katër orë ditën. Në mbrëmje zbrisnim në Portiçi e deri në Granatelo, unë, nxënësi dhe ati i tij, i cili, si më njohu nga afër, më deshi më tepër se çdo të huaj tjetër, që vinte në shtëpi të tyre. Çlodheshim pak diku në ndonjë kafene, pastaj ktheheshim në shtëpi me gjysmë ore natë. Nga Portiçi, më vonë, në verë, kaluam në Kastelamare, në banjat, në ujërat termale, dhe në shëtitjet mbi gomarë për Kuizizanë. Kur u kthyem përsëri në Portiçi, në shtator, m'u hapën damarët hemorroidalë dhe shëndeti më mori për të mbarë si kurrë herë tjetër.

Provimet që dha djali në nëntor e mbushën me gëzim familjen e tij, që ishte mbledhur, atëherë, e gjitha në shtëpi, në Napoli. Edhe unë kisha përfituar, duke përvetësuar aty shijën e rregullit dhe të ekonomisë, që atëherë, përgjithësisht, nuk njihej prej shtëpive arbëreshe. Vitin tjetër, shkrova, me një ankth të ethshëm, tragje-



dinë *Numidet*. Por as orët e papërshtatshme, të vetmet që kisha të lira, as leximet e Tit Livit dhe të Plutarkut, nuk kishin frymëzime për të më dhënë.

Nevoja për famë u bë për mua si një makth i vërtetë një vit më vonë, kur dashuria për një vashë të virgjër nga derë e madhe depërtoi në jetën time që, siç më dukej, nuk ishte aspak e pasur.

Në kohën e kreshmëve, mbasi m'blodha disa shokë, u lexova *Numidet*, por nuk vura re që të prekeshin. Isha i ligështuar, i ndrydhur nga një afsh përvëlues, që në mua shkoi duke shkrirë gjithçka dhe që ma kishte shndërruar frymëzimin në një dëshirë kapitëse. Por, kulti për një krijesë njerëzore, që më shmangu nga aspiratat e rinisë sime të parë dhe më ngatërroi me botën që më rrethonte, më liroi nga një varg të metash. Nxitësia me shpresa të papërcaktuara për një punë të madhe dhe të pastër. Shpirti i hyjneshës sime mbushej me idealet e mia dhe shpirti im me çfarë i pëlqente asaj. Dukuri e zakonshme në një miqësi me të vërtetë fisnike. Pasi kisha humbur shpresën për namin që mund të fitohet nga teatri, u mora me studime të tjera. Po atë vit botova në gazetën *Luçifero* «Hyjnizimet pellazgjike», të cilat u riprodhuan, më vonë, në botime të tjera dhe prej të cilave ishte vënë në dukje se vetëm gjuha shqipe ishte në buzë të politeizmit heleno-romak dhe se ajo ishte e vetmja në gjendje për ta shpjeguar atë. Profesor Dorotea i universitetit të Napolit e pranoi i pari tezën time dhe ma njohu zbulimin e njësimin të pellazgëve me shqiptarët, zbulim ky që, më vonë, u pranua dhe nga shkenca evropiane.

Rifillova, më vonë, botimin e *Serafinës*, në të cilën

hidhja fazat e ndryshme të figurës që më shkëlqente ditën dhe më linte pa gjumë natën. Por stilit aktiv të Milosaos të spërkatur me figura të freskëta, te Serafina e ripunuar i vihej përballë një tepri figurash e mendimesh, që i përmbyste aksionet dhe personazhet. Mbas saj, në këtë botë të pafund gjendej, siç thashë, një dëshirë e pafuqishme, ashtu si mund të jetë në një jetë, që është robëreshë e vështrimeve, e zërit dhe madje, edhe e heshtjes së një zonje. Kisha si shtytje e model poezinë frënge të asaj kohe dhe faktin se në krijimin e saj më shoqëronte jehona e pianos, që vinte së largu, nga dhomat e brendshme, me variacionet e saj monotone.

E pengonte, gjithashtu, krijimtarinë përpjekja e palodhur dhe këmbëngulëse për restaurimin e gjuhës shqipe, së cilës i qe këputur më se një tel. Fryt historik i këtyre shtatë vjetëve qe restaurimi nga unë i gjuhës amtare dhe i fisnikërisë së popullit që e flet, vepër që Atdheut i vlejti më shumë se çfarëdo vepër tjetër arti. Nga ana tjetër, edhe stili i Serafinës nuk u prit keq nga publiku. Ajo u bë shkak i një vizite të Alesandro Poerios së ri, vëllait të Karlit, që qe kthyer atë kohë nga Parisi. Atje kishte ndenjur një kohë të gjatë. Ai e humbi jetën e tij heroike më 1848, në rrethimin e Venedikut. Profesor Mazi, që u bë më vonë Kryetar i Administratës Qendrore për Studimet në Itali, në një artikull, nuk e mbaj mend se në cilën revistë, e krahasonte këngën e dytë me tablotë e mahnitshme të Biblës.

Këtu e ndiej të nevojshme ta kthej tregimin në ngjarjet e jashtme të jetës sime, në ngjarjet prej të cilave më shkëputi takimi, do të thosha, me Zanën, e cila më bëri, më vonë, që të jem i lidhur shpirtërisht me Onestët. Dhe kaq e thellë ishte, gjatë atyre viteve, shkëputja ime nga gjithçka, sa që vonë e mora vesh vdekjen, në lindje e sipër, të D. Angjelika Konfortit dhe s'munda t'i bëja të shoqit dhe nënës së saj një vizitë ngushëllimi për atë lule të pafat.

Im vëlla, Kamilua, si doli nga burgu, veshi petkun e priftit dhe, si u shugurua prift, erdhi në Napoli për t'u pajisur me arsimin shkencor. Por, për fat të mirë, një ditë, njëfarë imzot Engjëll Anton Skoti, delegat apostolik për kolonitë greke të krahinës së Napolit, duke kaluar për të kontrolluar përgatitjen arsimore, e pa këtë prift të ri dhe deshi të bisedonte me të, meqenëse i nevojitej për kishën greke të Leças. U morën vesh dhe Kamilua, mbas një jave, u emërua famullitar dhe u nis për në Pulje.

Kalorësi Spirit kish për xhaxha njëfarë duka Marota, shumë plak dhe, nuk di nëse beqar apo i vé, pa fëmijë. Për disa merita që kishte kundrejt Francës, që përjashtuar nga masat e marra për zhdukjen e feudalëve të Gjuzepe Bonapatit. Vdiq në atë kohë dhe e la feudin, të ndahej në mes vasalëve por e bëri të nipin, Spiriti, trashëgimtar të titullit të dukës dhe, ndoshta, të 100.000 dukateve të investuara në ndërtesat e tij, që i kishte në Napoli dhe në të ardhurat e Librit të Madh. Kalorës Spiriti, me gjithë familjen, veronte gjashtë muaj në vit

në Portiçi dhe në Kastelamare. Kështu që një ose dy herë në javë e shikoja Napolin. Orët e paka që qëndroja atje, nuk ishin të miat.

Në atë azil paqeje, mezi më erdhi jehona e revolucionit të Regjos, që dështoi mbas atij të Rimitit dhe të Bolonjës.

Një mëngjes, së bashku me dukën, erdhëm nga Portiçi në Imakolatela për të pritur kunatin e tij, baronin Pasalakua, që vinte nga Kalabria. Po me atë vapor erdhi edhe Gjovani Moshari, për të cilin kam folur në librin e parë. Ndërsa shkarkoheshin valixhet, u hoqëm mënjanë. E pyeta për gjendjen e njerëzve në Kozentino. «Italianët, – m'u përgjigj, – kanë rënë në gjumë të thellë. Ndërmjet arbëreshëve, përkundrazi, ka disa njerëz liberalë e të vendosur». Nuk kaluan as pesëmbëdhjetë ditë dhe më erdhi një ftesë nga komiteti kushtetues i Napolit, të cilit i caktova orën e mbledhjes. Atje, në shtëpinë e avokatit Avelino – që s'kishte pasur kurrë sukses në ndërmarrjet e tij – gjeta një rreth të ngushtë personash, pjesërisht të panjohur për mua. Kërkuan të nisesha e të vihesha në krye të një lëvizjeje të përgatitur në Kalabri. Atdheu nuk do të më linte pa ma shpërblyer këtë sakrificë. U parashtrova, miqësisht, ato që më kishte thënë Moshari. U kujtova fatin e vitit 1837. U thashë se atje nuk njihja njeri që ta donte Italinë deri në atë pikë sa të vinte në rrezik jetën dhe pasurinë. Ata më thanë se «Abrucet dhe Molizeja ishin gati për të ngritur krye, dhe se diversioni në Kalabri do të kishte qenë një ndihmë vendimtare». «E po mirë, – u thashë, – ky diversion, atëherë, do të jetë i lehtë dhe i rëndësishëm vetëm mbas një kryengritjeje të vërtetë

në Sanio. Nuk kam ndër mend të zbuloj veten dhe bashkatdhetarët e mi në një aksion që mund të dështojë». Kur u largova, m'u dukën të menduar.

Ç'është e vërteta, nuk e di nëse, edhe sikur të mos kishin qenë vështirësitë kaq të mëdha, do të mund të bëja gjësendi. Kurrë nuk kam shkuar me mendjen e të tjerëve.

S'kishin kaluar as pesëmbëdhjetë ditë dhe, pranë një ujëshitësi në Toledo, takova Domenik Mauron. Më dha dorën dhe më pyeti: «Çfarë do që t'i them babait tënd nga ana jote? Nesër do të nisem për në Kalabri. Jemi në pragun e një revolucioni të vërtetë dhe duhet të ndodhem atje». Desha t'i ndërroj mendjen. I fola për ato që më kishte thënë Moshari. «Moshari ka vajtur vetë atje qysh të shtunën» – ma ktheu Mauro. Ishte një djalë trim, por pa spërvojë. «Veç kësaj, ka më se një vit që jam bashkuar me ta, u kam dhënë fjalën dhe nuk mund ta humbas nderin duke u tërhequr tani, përpara rrezikut të aksionit».

U nis së bashku me pesë a gjashtë studentë. Mbas një jave, arbëreshë nga Shën Benedeto dhe nga Mandamenti i Çerxetos, gjithësej nja pesëdhjetë vetë, hynë një mëngjes në Kozencë që të nxitnin popullin të ngrinte krye. Qenë të gjithë djelmosha të zotë, të bashkuar jo nga gjësendi tjetër, porse vetëm nga një provë trimërie dhe të prirë drejt një vendi, ku u kishin thënë se i prisnin shokët. Në vend të tyre, përkundrazi, i prisnin ushtarë në këmbë dhe në kuaj, që, me t'u ndeshur me ta, hapën zjarr kundër tyre me njëfarë rregulli. Aty u vra komandanti i xhandarmërisë, i biri i filozofit të shquar Galupi, si dhe shumë ushtarë e kryengritës.

Ndërsa nëpër rrugë zhvilloheshin luftime, qyteti mbylli dyer e dritare dhe askush nuk e nxori kokën jashtë; kështu që arbëreshët, ndër të cilët të paktë ishin ata që dinin të mbushnin pushkën me njëfarë shkathtësie, të ligështuar, u tërhoqën dhe u strehuan ndër malet e të parëve, pa u ndjekur më nga ushtarët. Mauro u arrestua më vonë dhe u dërgua në Kozencë së bashku me Françesk Petrasin nga Çerxeto, një djalosh i dashur ky, i cili kishte qenë, së bashku me të vëllanë, Luigjin, një nga shokët e mi të dhomës në Shën Adrian. Vëllai i tij më i madh u dënua me burgim të rëndë së bashku me Rafael Kamodokan nga Kastroreggio, që kish dalë disa vjet më parë gjithashtu nga ky kolegji: që të dy të akuzuar se ishin vënë në krye të arbëreshëve kryengritës.

Moshari, që kishte dhe harxhoi shumë të holla dhe që kurrë nuk ka pasur zjarr në gjak, duke blerë dëshmitarë e magjistratë, mundi ta ndreqë punën e tij fare mirë, duke u dënuar vetëm me banim të detyruar në Napoli.

Por as për Molizen dhe Abrucin nuk u dëgjua më mbrapa.

**1899**

### III

Vashës së zemrës sime prindërit i përgatitnin një martesë që i përshtatej shkallës së saj. Mua më dukej se, mbas kësaj, jeta ime nuk kishte më asnjë kuptim. E shikoja që kishte rënë në një melankoli dhe besoja nga shkaku që do ta ndanin nga unë, sepse vitet, gjatë të cilëve ajo qe djegur si një qiri i ndezur në zbrazëtirë, nuk e kishin kredhur në trishtim.

Rreth asaj kohe kaloi nga Napoli Otoni I, mbret i Greqisë, që shkonte në Bavierë. E shoqëronte i biri i Miaulisit. Iu paraqita për të marrë vesh ndonjë lajm për të atin, heroin shqiptar, prijësin e kryengritjes helenike. Ishte një djalosh shtatmesatar, thatim, me flokë dhe mustaqe të zeza pis, me sjellje të përsosur. U gëzua, mund të them, kur pa sprovat e mia të para për të ringjallur gjuhën tonë amtare. Më këshilloi të shkoja në Greqi, duke më thënë që, kur të kthehej nga Bavierë, do të më merrte me vete në fregatën mbretërore. Kjo më gëzoi, por, gjatë qëndrimit të tij në Monako, marrëveshjet për martesë dështuan dhe mua s'kish njeri në botë që të mund të më shkëpuste prej saj. Në jetën time të brendshme të atyre viteve të shkujdesura, hedhin

blana drite fazat e saj, e Zanës tokësore, që reflektohen si në një pasqyrë në vjershat e asaj kohe, bijat e fatit tim.

## 2

Ndodhi që, atë verë, të shkonte nga Franca në banjat e Iskias poeti Lamartin. Ai ishte në kulm të karrierës së vet të shkëlqyer e të brohoritur. I shtyrë nga padurimi për të ditur nëse ndjenja krenare që kisha për veten time ngrihej mbi ndonjë bazë të shëndoshë, kur kaloi nga Iskia, i dërgova, me anë të një marinari, një kopje të *Milosaos* dhe *Këngët e botuara të Serafinës*. U fol në rrethin e miqve të mi për këtë guxim (thuhej se i kishte pritur letrarët e Napolit me mirësjelljen e një njeriu që nuk i njeh) dhe shumë nga familjarët e mi pritnin që mendjemadhësia ime të merrte dënimin e merituar. Kisha zënë shtratin nga dhimbjet e shpirtit, kur, mbas pesë ditësh, marinari u kthye me këtë letër:

«Zotni,

Jam i lumtur për këtë shenjë vëllazërie poetike dhe politike mes jush e meje. Poezia ka ardhur nga brigjet tuaja e aty duhet të kthehet. Unë nuk kam pasur asnjë meritë tjetër veçse që e kam parandier dhe që kam shprehur dëshirat e para për lirinë dhe ringjalljen e Shqipërisë. Ju më shpërblyet së tepërmi. Më vjen keq për shkakun që më pengon t'ju shoh dhe ju lutem të pranoni falënderimet dhe përgëzimet e mia.

Lamartin



Iskia, më 8 shtator 1844.»

Kur u kthye nga Iskia, i bëra një vizitë në hotelin e të huajve, në bregdetin e Kiajas. Më tha fjalë që do të ngjallnin një ndjenjë krenarie në zemrën e cilitdo. Pastaj, disa ditë më vonë, ndërsa po largohesha nga vila, bashkë me dy miq të mi, ai na kaloi pranë me familjen e kontit Lë Fevrë, në karrocë. Hoqa kapelen dhe e përshëndeta. Ndërsa karroca ngjitej në të përpjetën e rrugës, vura re se zonjushet Lë Fevrë u ngritën në karrocë, kthyen kokën nga unë dhe më shikuan, duke m'i ngulur sytë.

Në atë stinë, në mes kënaqësive të tilla, ndodhi të kthehej nga një udhëtim i shkurtër në Greqi bashkatdhetari im Tomazo Paçe nga Shën Kostantino. Ai punonte në Arkivin e Madh të Napolit që drejtohej, aso kohe, nga arbëreshi Mikel Bafi. Ky ishte i biri i të famshmit Paskal Bafi nga Shën Sofia, *njeri i pakrahasueshëm*, siç e quan historiani Bota duke folur për vdekjen e tij më 1799, i cili, si shumë arbëreshë të tjerë të ndershëm ishte rehabilituar nga Ferdinandi II. Tomazo Paçe njihnte greqishten e re dhe në të përkohshmen e Athinës *Minerva* botoi një përmbledhje të himnizimeve të mia pellazgjike mbi sfondin e politeizmit. Kur u kthye prej Greqisë, mori një letër nga Bukureshti në gjuhën greqishte, në të cilën qenë edhe këto fjalë: «Kur morën vesh se në ngulimet arbëreshe të Italisë lavrohet gjuha amtare, zemrat e shqiptarëve u ngritën peshë.» Këto ngjarje dhe kjo letër i orientuan, përfundimisht, mendimet e mia drejt krijimeve poetike për të nxjerrë në pah jetën dhe gjuhën e një kombi kaq fisnik dhe më fatkeq nga të gjithë.

Kështu që mendova, në radhë të parë, për një për-

mbledhje të plotë të këngëve tona popullore. Dhe, më nëherë, mbasi nxënësi im dha një varg tjetër provimesh përpara profesorëve të kolegjit të Shën Marçelinos dhe familja e tij mbeti shumë e kënaqur, i fola dukës për nevojën që ndieja për t'i kaluar pushimet e tetorit në shtëpinë time, për t'u ripërtëritur me shëndet dhe për të parë tim atë, pas shtatë vjetësh që isha ndarë prej tij.

U nisa, duke e pasur mendjen, vazhdimisht, tek vendlindja ime e dashur, ku dashuria e të gjithëve, qetësia e gëzueshme, erërat malore dhe puhia e detit, që dukej në largësi, më bënë ta marr veten, pothuaj, menjëherë. Takova, mbas pak, gjyshen nga ana e nënës, në shtëpinë e Brailes. Këtu mbledha disa këngë të bukura nga një grua plakë, Tortoshëlja, të cilën gjyshja ime, që ishte një grua shumë e dhembshme, e thërriste hera-herës e i dhuronte ndonjë send. Shkova më vonë në Shën Sofia, ku ime motër, Leticia, që ishte martuar atje që prej katër muajsh, më dha mundësi, nëpërmjet plakash të tjera të atij vendi, ta pasuroj përmbledhjen e Rapsodive të mia me këngë të tjera të bukura.

Në fillim të nëntorit mora, përsëri, udhën për në Napoli, ku më shpinte zemra. Për të shkuar atje më pëlqeu të udhëtoj nëpër det. Në gjysmë të rrugës nga Paola, u ndala në mbrëmje në Kavalerico, në shtëpinë e D. Luigj Melikjit, i vjehri i Çintia Feriolit, motra e kunatit tim në Shën Sofia. Kishte mbetur e vë prej pak kohësh. Të shoqin e saj e kisha pasur shok klase në Shën Adrian. Mbas darke, meqë bënte ftohtë, u mbledhëm rreth vatrës, ku zuri vend, pranë s'ëmës, një vashë e re, e bija e të zotit të shtëpisë, flokëverdhe, nja 22 a 23 vjeçe, e hijshme, me trup të hedhur, e hështur dhe e matur.

Mund të thuhet se as s'foli, as s'ndjeu fare. Në tryezë nuk kishte qenë, sepse te ne një gruaje nuk i ka hije të shtrohet në sofër me të huaj. Mbas pak u ngrit, dhe, e ndjekur nga shërbëtorja, hyri në dhomat e brendshme e nuk u kthye më. Të nesërmen në mëngjes i zoti i shtëpisë më kishte përgatitur shtatë trima të armatosur, që më pritnin te dera për të më shoqëruar. Malet qenë mbushur me cuba. U nisëm nëpërmes mjegullës, që kishte pështjelluar gështenjat dhe më lart lisat. Përpara kalit më ecte një plak, i ati i njërit prej cubave (*Nikariélji*).

Këtu u zgjata disi shumë, por kjo për arsye se të bijën e të zotit të shtëpisë, për të cilën unë atëherë nuk pata ndonjë mendim, do ta kisha shoqe të urtë në udhëtimin tim të vështirë mbi këtë dhé.

Në shpatin që zbret në Paola, nën një diell të ngrohtë e gazmor dhe me detin përpara syve, i falënderova dhe i shpërbleva ata që më shoqëronin dhe zbrita i lumtur drejt vendit ku ndalej vapori që do të më shpinte në Napoli. U nisëm ndaj mbrëmjes. Para mesit të natës na zuri një shqotë në gjirin e Salernos, kështu që atyre të vaporit iu desh të shkarkonin shumë gjëra e të ndaleshin. Me merak se do të vonohesha për të shkuar atje, ku më pritnin dhe, duke mos e ndier veten mirë ngaqë më kishte zënë deti, nuk e ndjeva, pothuaj fare, rrezikun.

### 3

Më largoi nga mendimet letra që mora të nesërmen nga Domenik Mauro, i cili më ftonte të takohesha me të në Shën Maria Aparente, ku e kishin shpërngulur që nga burgjet e Kozencës. E gjeta në një qeli tjetër,

jo në atë ku kisha qenë dikur dhe unë vetë, në fund të një dhome të madhe, ku kishte njerëz që qëndronin në këmbë dhe të tjerë që rrinin ulur. Ne u hoqëm mënjane, pranë derës. Mbasi i dhashë letrat që i dërgonin njerëzit e tij, ai më tha shqip këto fjalë: «Do të kisha dashur të isha takuar me ty, para se të niseshe për Kalabri. Kisha disa lajme që do t'i ngrinin atje zemrat peshë. Këtu me ne është Bokaçiami, shok i vëllezërve Bandiera, i cili, për hir të përçapjeve të qeverisë frënge, do të dalë së shpejti nga burgu. Ai ka 700 të rinj të legjionit të huaj të Afrikës. Dhe, menjëherë, porsa të ketë në Kalabri zotërinj, të cilët t'i premtojnë se nuk do ta lënë vetëm, është gati të zbarkojë në bregun që do t'i caktohet». «Unë isha i sëmurë, iu përgjigja, dhe nuk pashë askënd; por këtu brenda juve ju kanë kurdisur një kurth. Në kohën e vrasjes së vëllezërve Bandiera, Palmerstoni, kur e pyetën në parlament, deklaroi se ata i kishte dorëzuar në qeverinë e Napolit njëfarë Bokaçiami, i cili spiunonte, për llogari të Austrisë, të mërguarit italianë». — «Po nuk është e mundur, më tha ai. Këtë e thonë disa gazeta të ndyra, që paguhen qëllimisht për ta diskredituar». — «E përse, atëherë, i thashë unë, nuk pësoi edhe ai fatin e shokëve të tij?» — «Sepse, m'u përgjigj, nuk u kap në përleshjen me milicinë e qytetit». — «Kish qenë lajmëruar më parë; nga ana tjetër, shokët e tij nuk kanë zënë kurrë armë me dorë. Pastaj, të pyes, si vjen ky njeri në një vend armik, pa e ftuar kush dhe pa pasur njeri që ta presë?». — «I dashur Jeronim (ma ktheu ai), e ke gabim. Ai është njeri serioz, me pikëpamje të gjera, veç ta njohësh». — «Jo, nuk dua ta njoh. Po le ta lëmë këtë bisedë. Vetëm vini re një send:

derisa ai paska pasur një legjion të huaj, përse erdhi këtu tek ne me dhjetë të ngordhur? Ku i ka lënë trupat që ta presin? Kush ia ushqen?». Këto pyetje sikur e bënë të mendohej mikun tim. Unë, ndërkaq, u largova duke menduar me veten time: «Që, ndoshta, udhëtimin tim mund t'i japin një kuptim politik ata që merakosen për këtë gjë dhe që Bokaçiampin e kishin futur atje që ta zbulonte».

Dhe, me të vërtetë, mbas pak kohe e hoqën që andej dhe, se ç'u bë më tej me të, këtë nuk e mori vesh njeri. Mauron e shpunë në një burg më të keq dhe vigjilenca e policisë ndaj meje u bë më e madhe. Një ditë, afër krishtlindjeve, takova vëllanë e Benedeto Muzolinos, që kishte dalë nga burgu. Më porositi të jem shumë i matur, sepse isha një nga ata të dhjetë njerëzit e dyshimtë të lagjes Montekalvario. Ai e dinte mirë këtë gjë, sepse, aso kohe, ishte mjek pranë komisarariatit të policisë të asaj lagjeje.

Isha njohur në zyrën e Omnibusit të Vinçenc Torelit me kalorësin De Çezares. Kishte botuar një libër të bukur me vjersha të lehta dhe e mbante hapur sallonin e tij për letrarë të njohur dhe për të rinj të aristokracisë. Kalorës Gjuzepe de Çeçare, një liberal i vjetër, mblidhte në sallonin e vet ç'kish mbetur ende nga liberalizmi i 1820-ës. Unë, shumë i ri ndërmjet pleqësh, isha njohur me të me anën e njëfarë Napoleon Kazili, mjek asistent në Spitalin e të Pashërueshmve. Më 1839 më kishte dhënë mësim private në osteologji si mua ashtu edhe Dhimitër Strigarit, Akil Frashinit dhe Gjuzepe Masaritit, i cili mbajti, më pas, temianicën përpara Gjobertit, që të katër anëtarë të *Italisë së Re*. Që të gjithë ata zo-

tërinj ishin volterianë, por njerëz të drejtë dhe dashamirës ndaj meje.

Kati i parë i pallatit, ku banoja, ishte pronë e familjes Del Poco, që përbëhej nga nëna plakë, nga një prift, D. Luigji, kapelan i mbretit, dhe nga vëllai i tij, Ferdinandi, funksionar i lartë në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Ky, në konfliktin e mademeve të sqfurit të Sicilisë me Anglinë, kishte qenë dërguar nga Napoli në Francë dhe bëri që ajo të ndërmjetësonte në këtë çështje. Si u paqëtuan punët, u kthye në vendin e vet dhe i jepte dukës gazetat e Francës që i vinin në Ministri.

Ndërkaq, mora disa letra nga Kamilua, prej Leçes, që më njoftonin se si, nga një sëmundje e rëndë në krahë, mjekët e kishin këshilluar të shpërngulej në ndonjë spital të përshtatshëm të Napolit, ku nuk do t'i mungonte edhe konsulta e mjekëve të dëgjuar. Me ndërmjetësinë e Gjuzepe Epifanit, të cilit unë nuk munda t'i provoj mirënjohjen time, duke ndërhyrë edhe imzot Engjëll Anton Skoti, nxori lejen e udhëtimit nga qeveria si edhe 20 dukata në muaj. Ato i jepeshin për të përballuar shpenzimet e nevojshme në Spitalin e Paqës, që ishte themeluar për priftërinjtë. Me të arritur, vajta ta takoj dhe e gjeta në shtrat, të dobësuar dhe të kredhur në një trishtim të thellë. I premtova se do ta ndihmoja. Po atë javë, të shtunën, shkova e takova në shtëpinë e kalorës De Çezares një mikun tim që ishte asistent në Spitalin e të Pashërueshmve. Iu luta të kalonte në Spitalin e Paqës dhe, mbasi ta vizitonte me kujdes tim vëlla, të më thoshte se si ishte me shëndet dhe të më

jepte ndonjë këshillë. Të shtunën tjetër, mbasi hyra në sallonin e De Çezares, Kazili, që ishte atje, u ngrit në këmbë dhe më tha: «I dashuri De Rada, shpura në Spitalin e Paqës dy mjekët e parë të Spitalit të të Pashërueshmve dhe, mbas vizitës, më vjen keq t'ju them se vetëm zoti do të mund ta shëronte vëllanë tënd».

Të dielën në mëngjes u hodha një vrap në Spitalin e Paqës dhe e gjeta Kamilin shumë të mërziur. «Erdhën, – më tha, – dy mjekë të parë të Spitalit të të Pashërueshmve, të shoqëruar nga një asistent që të njihete. Më vizituan imtësisht për një kohë të gjatë dhe arritën në përfundimin se vuaj nga një tuberkuloz në një fazë shumë të përparuar». Dhe, në atë e sipër, më tregoi një kupëz, që e mbante në krye të shtratit, plot me ballgame, duke më lutur që të mos i shkruaja gjë për këtë babait.

Në vetvete ngjarjet e jetës sime nuk kanë absolutisht asnjë vleftë për njeri. Nga ana tjetër, unë nuk kam as ndonjë arsye që të mburrem me to. Por në atë mënyrë që unë i dhashë veprimin dhe kamjen (bërjen dhe pasjen) lartësimit të gjuhës amtare, ruajtëses së Atdheut shqiptar, po ashtu po parashtroj ndodhitë e jetës sime për vlerën e pashoqe që përmbajnë.

Kamilua, mbasi u shërua, u kthye në Leçe. Më 1855 u bë famullitar në Maqë, duke zënë vendin e atit tonë, që aso kohe vdiq. Dhe jetoi deri më 1883.

#### 4

Vitin tjetër erdhi nga Siçilia në Napoli, si famullitar i kishës greke të Fiorentinëve, Dhimitër Kamarda, shqiptar

i vërtetë në zemër e në mendime. Ai vinte e më takonte vazhdimisht në vilë në orët e shëtitjes, dhe bisedonim bashkë rreth ringjalljes intelektuale e morale të kombit tonë. Kamarda kishte sjellë nga Siçilia një dorëshkrim shumë të vyer me këngë shqiptare dhe disa letra të Gjan Françesk Avatit, lindur në Maqë në shekullin XVIII dhe vdekur në Urbino si katedratik.

Nga Urbinoja qenë nisur edhe shumë letra të tij, që ruhen në Maqë, në shtëpinë e nanëgjyshes sime. Në vizitën që bëra në Shën Kozmo, e për të cilën folam në periudhën e dytë të jetës sime, pashë edhe një libër, të tij, që ishte gjetur në bibliotekën e D. Fluminio Toçit. Përbëhej nga dy tema. Nga legjenda e fluturimit të kornizës së zonjës së këshillës së mirë nga Shkodra e Shqipërisë në Gjenecan, dhe nga një letër shoqërimi për një pako me këngë të lashta shqiptare, të mbledhura nga goja e popullit, të cilat ai ia dërgonte rektorit të PP Olivetani të Palermos. Ky lajm më bëri të sigurohem që dorëshkrimi me shkrimin dhe në dialektin e Avatit ishte koleksioni i tij, që na kishte ardhur nga Palermoja nëpërmjet Kamardës.

Bashkëkohës me Avatin që poeti Jul Variboba nga Mbuzati. Të dy, ndonëse me një mospajtim të dukshëm, shënojnë një moment të rëndësishëm në fatin e kombit tonë, që pasqyrohet në veprat e tyre.

Poezitë e Varibobës, të lehta, të rimuara, që paraqesin me besnikëri jetën reale, patën më fat sesa poezitë tradicionale, për ruajtjen e të cilave Avati bashkëpunoi. Dhe kjo sepse subjektet fetare, të zbukuruar nga rima, depërtuan dhe mbisunduan në rrethin e grave, duke bërë që të lireshin mbas dore këngët e lashta të



trimërisë, të frymëzuara nga zakonet, nga ngjarjet, nga ndjenjat kombëtare dhe që shoqëroheshin nga fusalet, koret rituale të këngëve. Mbas ca kohe, edhe këto vjersha u lanë mbas dore, pa e tërhequr dot popullin drejt perëndisë, si ato që ishin jehona të *detit tingëllues priftëror*, të zhveshura nga çdo vajim shpirtëror. Në ditët tona ai pati një kundërshtar, për sa i përket lehtësisë së stilit. Kosta Beluçin nga Shalja e Shën Mitrit. Gjuha, si e njërit ashtu edhe e tjetrit, është e mbushur me huazime italiane dhe rima, që e ftoh fantazinë, te Variboba ndihmohet nga fjalët italiane ndërsa te Kosta nga Shalja pengon fjalën të rrjedhë. Për Varibobën dhe për familjen e tij nuk kam ditur asgjë. Avati ishte nga një familje fisnike. Në krahinën tonë ka një rrugë me emrin *Kont Avati*. Në kishën e famullisë, në të majtë të altarit të madh, ndodhet kapela e Avatëve me një emblemë, e cila ka një helmetë sipër saj e lirin me luanin që ka çuar këmbën në fushë bojë qielli. Gjatë pushtimit frëng, ndërmjet cubave opozitarë, ka qenë edhe një Mikel Avati nga Maqa, një nga më të tmerrshmit syresh. Në Napoli, në Trininë e Spanjollëve, gjatë kohës që banoja në shtëpinë e Spiritit, një kont Avati banonte në pallatin përballë dhe kishte një vajzë për të cilën thuhej se ishte nga më të bukurat e Napolit.

Ky largim nga studimet, që kishte për shkak Kamar-dën dhe ngjarjet politike të shtetit roman, më ndihmoi që të mos e ndiej ose, më mirë të them, që ta zbus vuajtjen që më shkaktoi një ngjarje, të cilën do ta tregoj tani.

Një natë të karnavaleve, ndërsa ndodhesha në San Karlo me familjen e zonjës, në palkun e tyre të radhës

së parë, na u afrua një maskë nga plateja. U kthye nga virgjëresha e re e i tha: «Po ju, zonjushë, nuk ju gjejmë kurrë atje ku ju lëmë». Fytyra e vashës u skuq e u bë flakë. Nuk tha asnjë fjalë. Kur dolëm, ajo u shty prej turmës ca hapa përpara në treme e arrita dhe i thashë i qetë: «Pra, kini ditur të gënjeni». Ajo, e turbulluar, u largua bashkë me njerëzit e saj dhe u ngjit në karrocë.

Nuk e mora vesh kurrë cili qe, njeriu që fshihej mbas maskës dhe as desha ta di ndonjëherë. Shpirtërat tanë qenë ndarë tani në një mënyrë të pandreqshme, ndonëse secili kishte mbetur thellë i plagosur. Atë e pllakosi brenga e vetmisë. Më se gjashtë vjet e kishte lënë zemrën të ndiqte një re, që kishte lindur për t'u zhdukur në ajrin e zbrazët. Kjo zgjidhje, që bënte pjesë në parashikimet e mia të përditshme, më çlironte, si të thuash, nga një njollë – mendimi se tek ajo unë dashuroja jo njeriun, por pasurinë (50.000 dukatë pajë), gjë që më brengoste thellë. Po kur, mbas 40 vjetësh, fati na bëri që të takohemi përsëri, ajo e vé dhe pa fëmijë, unë i lënë shkretë nga dy djemtë, të cilët m'i kishin zili të gjithë, ndiemë që të dy se në zemrat tona të heshtura plaga nuk ishte shëruar.

## 5

U përkujdesa për një botim të dytë të *Milosaos*, të cilit nuk iu kursyen lëvdatat dhe miratimet. Në botimin e tij të ri dhe të shkëlqyeshëm botova njërin pas tjetrit *Katër historitë e Shekullit XV: Ana Maria Kominiate, Adine, Nata e krishtlindjeve, Videlajde*.

*Milosaos*, mbas 1841, i kisha shtuar, në çastet e lumtura, disa krijime të thjeshta homogjene, që e lidhnin artistikisht thurrien, dhe që, ndonëse të pakta, mjaftonin për të më kënaqur mua dhe të tjerët. Shtojcat që iu bënë skeletit të *Katër historive* më 1845 dhe 1846, paraqitnin interes jo për shkak të gërshetimit, po për shkak se bota që paraqitej ishte e plotë. Pasioni që lëngonte gjatë atyre viteve në shpirtin tim, i nxitur edhe nga stili që ishte atëherë i *moës*, më shtynte të ndalesha më tepër në paraqitjen e njeriut dhe të natyrës, në dëm të ritmit të shpejtë të veprimit. Dhe prandaj u shquan për një kumbim mendimesh, figurash dhe ndjenjash karakteristike për Shekspirin, ndonëse u mungonte drama e këtij poeti të madh, si e ndriçuar nga dielli i mesditës.

Dua të kujtoj se si, në atë kohë, më erdhi, i rekomanduar nga Kamilua, i biri i gjykatësit që kishte vdekur. Duke mos pasur me se ta ndihmoja, i dhurova dorëshkrimin e *Odisesë*, një poemth me rimë të alteruar / strofë treshe danteske / , me përmbajtje kombëtare, që e kisha shkruar kur isha në kolegjin e Shën Adrianit. Ai mundi ta botojë, duke ia kushtuar së shoqes të Ministrit të Punëve të Brendshme S. Angjelo, e cila rridhte, siç thoshin, nga ca princa shqiptarë, dhe mburrej për këtë. Kushtimi nënshkruhej nga Saverio de'Markezi Pirro, të cilit kjo zonjë fisnike i dhuroi 250 dukatë. Kam një copë të veprës së botuar.

#### IV

Qyteti ishte i pushtuar prej frike. Pjesa më e madhe e dyqaneve mbetën mbyllur. Ministria e budallenjve kishte dhënë dorëheqjen që prej disa ditësh e nuk mund të formohej një ministri e re. Në orën 7 paradite mora një pusullë prej poeteshës Gjuzepina Guaçi, që sapo e kisha njohur e që lexonte shqip. Kishte dëshirë të më shihte. Dukej më simpatike prej melankolisë, shkaktuar prej një sëmundjeje të lehtë të gjoksit. «Ah, mos do ta humbim, – më tha, – kushtetutën, për punë të atyre që nuk kanë menduar për të?». E aty, të dëshpëruar të dy, vendosëm, sipas këshillës së saj, që të shkoj te Gabriel Pepe për ta lutur të pranonte formimin e ministrisë që i ishte ofruar prej mbretit. Gabriel Pepes, deputet në parlamentin e vitit 1820, i ishte dashur të mërgonte prej mbretërisë. Në Firenze i ishte dashur, për nderin e Italisë, të bënte me Lamartinin një dyluftim, që kishte dalë me dobi. Pas dhënies së kushtetutës, ishte kthyer e gjenerali i rojës kombëtare, princi di Strongoli, Pinjateli, e kishte emëruar kolonel të asaj arme, sepse ishte puthitur me besën dhe fisnikërinë e shpirtit të tij. Shkova me ngurrim se nuk e njihja. Edhe Guaçi nuk e njihje fare. Ishte duke dalë prej shtëpisë me uniformë, i lartë

me shtat e me pamje burri. Më priti në këmbë. Më dëgjoi e më kundërshtoi duke thënë se nuk ishte thirrur prej mbretit. Edhe sikur të bindej, kudo që të ishte, nuk njihte kënd ta thërriste në anën e vet. Ai kishte ardhur në Napoli para pak kohësh dhe e kishte gjetur shumë të pështjelluar. I parashtrova se si mund të çlirohej prej këtyre dy vështirësish. Më miratoi e dola për të parë gjeneral Lekën. Më nderonte me konsideratën plot dashuri. Doja ta pyesja a do të mundte t'ia kujtonte mbretit Gabriel Pepen. Ngava me të shpejtë në rrugën Karminele a Kiaja, dhe, mareshalit shumë të egërsuar me Saliçetin, i fola për Pepen. Meqenëse prej shumë kohësh mbreti nuk këshillohej me të, ai më dha një biletë për gjeneral Filagjerin. Nuk e gjeta në shtëpi, pak përpara ishte thirrur në pallat. Ishte një ditë shumë e nxehtë prilli. Shkoja duke kujtuar vargjet e përmendura të Tasos:

*Pas një gjahu të gjatë e të mundshëm, kthehen të zymtë e ngashërues zagarët», etj.*

Në drekë u njoftova njerëzve të shtëpisë për mosesin tim. U brengosën shumë. U çova prej tryezës po nuk mund të bëja pushimin e shkurtër të zakonshëm. Duke shëtitur nëpër dhomë, me një stuhi të madhe mendimesh, ndjeva sikur më thoshin nga brenda: «Çfarë ndihme u kërkon njerëzve që kanë kundërshtuar një kukull kur ke në dorë një gazetë që flet për të?». Menjëherë u vura në punë e shkrova një artikull të shkurtër plot vërtetësi.

Aty ia paraqitja Saliçetin popullit që ta përbuzte. Gazeta do të dilte atë mbrëmje. Zëvendësova akuzën në kryeartikullin. Brenda njëzet e katër orësh një shërbëtor i shtypshkronjës shpërndau tridhjetë kopjet e para nëpër kafenetë më të njohura të qytetit. Në treçerek natë dola vetëm nëpër rrugë për të parë efektet. Kishte shpërthyer një zjarr. Në kafe të Napolit, në Toledo, plot me klientë në këmbë, poeti Regaldi, që kishte ardhur te ne para disa muajsh, hipur mbi një bankë lexonte me zë të lartë gazetën. Rreth orës dhjetë, kur u kthye familja e dukës prej shtëpisë së këshilltarit të hetuesisë, kalorësit De Çezare, ku kishte kaluar mbrëmjen në një shoqëri të madhe, më kallëzuan se gazetën *L'Albanese* e kishin shpënë e u lexua me kaq duartrokitje, sa që dukej se nuk ngopeshin më me të. Si agoi dita e re, u pa artikulli i riprodhuar në formate të ndryshme, afishuar ndër skaje të rrugëve.

Atë ditë në mëngjes ndesha ndër shkallë bashkatdhetarin tim, me trup të shkurtër, Françesk Mashi prej Shën Sofisë, që banonte në një dhomëz nën dritaren time. Atij i vinte, nganjëherë natën, Saliçeti. Porsa më pa, më tha: «Jeronim, edhe ti nuk flet të vërtetën. Saliçeti as ka përkthyer dhe as nuk i ka kushtuar psalme ministrit të policisë. Ka për të ngritur padi kundër teje duke u ankuar për shpifjen që i është bërë». U turbullova shumë. Nuk e kisha parë librin, por kisha dëgjuar të flitej. Përgjithësisht më bëjnë të rrëqethem avokatët pedantë. Po zbrisja me nxënësin prej vilës e u ndesha me Biagio Gamboan, përkthyesin e Kalderon de la Barkës, njeri me rëndësi, që parlamenti i vitit 1820 e kishte dërguar si ambasador në Spanjë.

Sa më pa, erdhi tek unë e më përshëndeti duke më përgëzuar. Por unë i fola për vështirësinë e ré. «Ai nuk ia kushtoi psalmet, — shtoi ky, — por Jovi. Kam një kopje, mund ta shihni.» U kthyem së bashku në qytet. Pas një gjysmë ore që kisha arritur në shtëpi, erdhi shërbëtori i tij me libër. Duke qeshur, ia dëftova prej dritares mikut tim. Saliçeti natën u zhduk e prej tokës papnore protestoi në gazetën *La Nazione*, nëse nuk gaboj, kundër qeverisë që donte t'i hiqte rrogën e gjykatësit.

## 2

Mbasi u qetësua sheshi kryesor, mbas një bisedimi të gjatë të kotë, mbi premtimin që kushtetuta t'i zhvillojë tri fuqitë, historiani Troja mori përsipër Kryesinë e Ministrisë. Atë të Faljes dhe të Drejtësisë e mori Rafael Konforti, ish-kryetari im. Me atë nuk ishim parë e as u pamë më. Të pushuarit prej pune në shpresën e zhdukjes së Saliçetit, u shpërndanë si një tharm i keq nëpër krahina. E filluan, nga të gjitha anët, me gënjeshtër të fëlliqura, të egërsonin shpirtrat me shumicë në Kalabri. Ndërkohë, në Kozencë, baron Marsiko nuk ia dilte të qetësonte të gjithë të pakënaqurit. Parlamentarizmi nuk i kishte bërë ende të përbashkëta pasuritë e privateve, dhe as shteti kushtetues nuk kishte përforcuar ende lëvizjen e vendit, që i ishte urdhëruar. Intendenti, njeri fisnik, nuk dinte edhe ai ku të merrte për të dhënë. U çuan kundër, o nga nevoja, o pse deshën ta ndalojnë. Prijës ishte Domenik Mauro, prej familjeje pasanike, me shpirt të lartë. E ndiente veten të fyer se ishte lënë pas

dore me qëllim. Ishte njeri që u vinte veshin njerëzve të parëndësi, liberalëve të së nesërme, shokëve të klu-bit që ishin ndër të zgjedhurit e vet. Këta do të nda-nin së bashku përbuzjen e tij. Përveç pasionit të hollë, zotëronte edhe talentin demagogjik. Një mori njerëzish i mblidhej vazhdimisht pranë.

Ndër ato javë dyshimi, Beteli më kërkoi me anën e një letre, duke më paraqitur gjysmën e pajtimtarëve, shkrirjen e *Albaneses në Costituzionale*, për të cilin do dilte një kundërshtar i fortë *Tempo*, organ i Trojas, lu përgjigja me thjeshtësi: «Nuk dua të hiqet prej meje, as nuk mund të urdhëroj natyrën time të egër t'u bin-det opinioneve e qëllimeve të komiteteve e, përgjithësisht të të tjerëve». Dhe mbeti e pavarur gazeta ime e, bash-kë me këtë, mbeti e pavarur edhe fletorja *Omnibus*, pronë e bashkatdhetarit dhe mikut tim Vinçenc Torelit prej Barile në Bazilikatë. Nuk më kujtohet me saktësi a qe para apo mbrapa këtyre ndodhjeve. Përsa u takon datave, nuk kam siguri. Më mungojnë numrat e *L'Alba-neses* e mendja ime, e kapur gjithmonë mbas ngjarjeve, nuk shikonte, as pak as shumë, data ose rrethana të tjera (kërkoj të falur për pasaktësinë nga kjo anë). M'u dërgua *l'Apostolato* i Françesk Krispit nga Kolonia jonë e Palac Adrianit. I çova të gjitha numrat e *Albaneses*. Shkëmbimi vazhdoi derisa furtunat e arritura i zhytën, përnjëherë, të dyja këto të përkohshme.

Pak kohë pas këtyre ngjarjeve të sipërtreguara, u bë e qartë lakmia e Sicilisë për autonominë e vet adminis-trative. Ajo u bë, papritmas, ankthi i këshilltarit tim të vjetër Emanuel Biderës, i lindur edhe ai në Palac Adriano. Në çështjen siciliane pretendimi që më dukej se vinte



prej Napolit, për të sunduar ishullin, më shtynte të mendoja se rridhte prej vullnetit të mbrapshtë. Prandaj nuk e bëra objekt diskutimesh. Iu shmanga, me vendim të prerë, çdo ndërhyrjeje, duke egërsuar kundërshtimet civile në Itali, që na kishte miq aq të dashur.

Gazeta të tjera, edhe pa pasur prirje për Sicilien, i jepnin arsye, vetëm pse ishin lajmet e para fatlumtura të kryengritësve që ringjallnin thirrjet e atyre që shpresonin dhe të të pakënaqurve. Ndërkaq ndodhi që një ditë u pa i varur në trarin e një dritareje të pallatit të vet, nën sheshin e Merkatelos, i biri i markezit Vulkano.

Gruaja e tij, motra e baron Beletit, kishte kurvëruar me të vëllanë e mbretit, princin e Sirakuzës. Mbreti, mbas këtij fakti tragjik të vejën me katër fëmijë e largoi prej shtëpisë mbretërore dhe e internoi në Firencë. Por turpi nuk u shlye prej shpirtit fisnik të Beletit e *Costituzionale* e tij, që ishte shumë e përhapur në Napoli, helmonte çdo veprim të oborrit mbretëror.

Kaq ishin trazuar shpirtërat e njerëzve, sa dukej sikur nuk mund të qetësoheshin dot.

Në një ndër ato ditë, gjeta në postë letra të një ati domenikan prej Kastrovilari, Rafael Orioli. E kisha për zemër e më vinte në dijeni: «Se krahina, mbasi kishte marrë njoftim për lodrat tradhtarë të Borbonit, ishte njësuar e gjitha për një kryengritje të ardhshme me zjarr të gjerë; se i kisha bërë të qarta radhët reaksionare në gazetë e se populli do të qëndronte pas meje». Iu përgjigja siç duhej murgarit e gjeta rastin të shoh në shtëpi të tij Karl Poerion, drejtor i Punëve të Brendshme. Nuk u turbullua për këto lajme. Më tha se si këto ashtu

edhe të tjera kishte marrë prej intendentit Marsiko. I dukej se nuk kishte ku të mbështeste dorën. Nuk mund të rëndonte vendin me mjete të padrejta duke mbajtur gjithë ata të papunë, dhe as nuk mund t'u gjente këtyre vende duke përjashtuar njerëz që i kishin dhënë shtetit punën e jetës së vet e që nuk ishin fajtorë për kurrgjë.

## 5

Në këtë gjendje shpirtërore u bënë zgjedhjet për parlament dhe hapja u dekretua për 15 maj.

Në mbrëmjen e datës 13 (e shtunë), anija e Kalabrisë shkarkoi, bashkë me deputetë, një numër prej 90 djemsh të rinj, të gjithë me pupël të zezë në kapelë. Një rojë si këta u desh të përcillte edhe deputetët e krahinave. Shumë të rinj të shteteve të tjera të Italisë ishin shpërndarë prej kohe nëpër pijetoret e kryeqytetit. Të dielën deputetët u bashkuan në Monteoliveto në mbledhje përgatitore e filluan komunikimet me ministrinë mbi qëllimet e veta për të shndërruar kushtetutën. Nuk mundën të bien në marrëveshje me mbretin. Rreth orës 24, ministria dha dorëheqjen dhe, mbas një ore, rruga e Toledos filloi të përforcohet me ledhe. Kryetar i mbledhjes së parë që kryedjakoni Kanjaci, me origjinë arbëreshe prej Pulje. Për shkak të pështjellimit të mendimeve, të nesërmen dha dorëheqjen.

Rreth orës dy të natës, nëpërmjet ministrave të rinj, iu bë e ditur mbledhjes pëlqimi i mbretit se po shpallej kushtetuta. Ky lajm i kënaqi më të shumtit dhe ata u larguan. Ata që mbetën, dhe populli përjashta, kërkuan,

përsëri, me anën e një lajmi të ri një betim se do të shpallej dhe do të modifikohej kushtetuta. Natën vazhduan përforcimet nëpër rrugë. Me këtë punë u zu edhe roja kombëtare. Kur shkoi komandanti Gabriel Pepe për t'i tërhequr ata filluan të humbin respektin. Në mesazhin e fundit mbreti pranoi të bëhej betimi për shpalljen e një kushtetute po të shpartalloheshin barrikatadat. Këtë nuk ia pranuan.

Prej mbretit që thirrur dhe pyetur, atë natë, marshali Leka. Ky e këshilloi t'i përmbahej kushtetutës, për të cilën ishte bërë betimi më 10 shkurt dhe asaj t'i qëndronte besnik. Të nesërmen drejtimi i betejës iu ngarkua atij.

Porsa agoi drita në mëngjesin e së hënës, dëgjova buçima buriash. Brofa nga shtrati, pashë një barrikadë të madhe në qoshen e rrugës Sh. Gjakomo, që mbrohej prej ushtarëve të gardës. Nga ora shtatë u ula në shtëpinë e mikut tim Fr. Mazi. Nga xhaxhai i tij, deputeti Çezar Marini, mora vesh fill e për pengjarjet e ditës së mëparshme. Ishte i kënaqur për prishjen e mosmarrëveshjes e kishte besim për këtë. Desh të shkoja me të në Dhomë për të qenë i pranishëm e për të lajmëruar në gazetë për luftën që do të niste kundër të çmendurve. Nga ora nëntë, së bashku, shkuam nëpër rrugën Lungo Teatro Nuovo. Pak më përtej teatrit, dëgjuam, prej së largu, një batore armësh e prapë disa të tjera më afër. Nuk ishte, pra, e përshtatshme për mua më Dhoma dhe nuk dija se çfarë vendi tjetër më i mirë më kishte mbetur. Lashë deputetin Marini e u ula nëpër Monte Kalvario në Toledo. Më kaloi përpara Gjuzepe Samengo (arbëresh nga Lungro, sot këshilltar i hetue-

sisë në Romë). Po zbriste i armatosur me një pushkë. Më tha se ishte e fundit që qe e mundur të sigurohej. Në fund të Toledos bëhej luftë. Ballkonet mbi Largo dela Karita ishin plot me studentë të armatosur. Ndër këta kishte shumë kalabrezë. Mua, si i paarmë, nuk më mbeti tjetër veç të largohesha prej vendit të betejës.

Në shtëpi prej një kapiteni që kishte dhënë dorëheqjen, prej Beluçit, dëshmitar me sy, mora vesh se kapitenin Sales të zviceranëve, duke urdhëruar që t'i hapej rruga mbretit për të shkuar në parlament, e qëlluan me armë nga pallati Çirela dhe ai ra prej kalit. Për shkak të goditjes shpërtheu një e rrahur shuplakash prej të gjitha ballkoneve të Toledos. Mbas pak minutash, zviceranët hapën zjarr. U erdhën në ndihmë trupat e marinës. Kaster Nuovo filloi të mitralojë ata që ishin kundruall ndër ballkone. Kryengritësit, të mbrojtur prej dyshekëve, që i mbanin pezull, shtinin kundër trupave. Këta, të bashkuar e duke qëlluar në shenjë papushim në paftat që mbyllnin portat e mëdha, i shpartalluan. Ushtarët zunë rob e mbytën ata që u gjetën ndër hekurat e ballkoneve. Topat shpërthenin barrikadat që ishin gati pa asnjë njeri, por që mbroheshin nga të shtënat që vinin prej pallateve sipër. Të burgosurit ishin çuar në Darsena. Kështu u luftua deri në mbrëmje, kur, me anën e fishekzjarreve ndezëse, iu vu zjarr pallatit Riçiardit, ku rrinte komiteti drejtues i kryengritjes. Zjarri vazhdoi gjithë natën. Një britmë e papërshkrueshme e vegjëlisë, përkrahëse e mbretit, që ishte mbledhur para mbrëmjes në Toledo me flamur të bardhë, brohoriti për fitoren e mbretit. Disa nga kryengritësit, që nuk mundën të fshihen, u rruan e u maskuan që të mos njiheshin. Trupat fushuan

gjithë natën ndër rrethe. Të nesërmen në mëngjes u shpall shtetrrëthimi. Megjithëkëtë, as dyqanet u çelën, as u duk ndonjë civil. Kryengritësit e shpëtuar iknin ndër krahina. Atje venin edhe ata që kishin qenë burgosur në Darsena. Rrugët përshkoheshin nga rrugaçë. Desha të shoh qytetin. Aty sillej një karrocë e madhe të vdekurish. Ndër lagjet përposh, nëpër rrugë dhe nëpër kopshte të hapura hidhej valle sipas krismave të lodrave. Nuk shiheshin më fletë të shtypura, që dje qenë aq të shpeshta. Kur u ktheva në dhomë, nuk munda të qetësohem. Thura një tregim. Në orën një të natës relacioni ishte radhitur në shtyp për një shtojcë të *Albanese d'Italia*. Duhej të shpërndareshin kopjet natën. Nga ora 8 e paradites isha thirrur në komandën e Piacës si shkelës i shtetrrëthimit. U mbajta në një dhomë ngjitur me kabinetin e komandantit Lubrano. Mbas gati tri orësh munda të paguaj një ushtar e t'i shkruaj Lekës, të cilit i kisha dërguar në mëngjes fletën. Ai i shkroi Lubranos dhe m'u dha leja të dal. Lirimi im qe një mjet shpëtimi për gazetën, që u përhap si ujë i ftohtë mbi gënjeshttrat e nxehta të përhapura nëpër krahina. Për këto, deri në orën dhjetë të ditës së enjte, u dërguan 3200 kopje të shtojcës. Shtetrrëthimi u dobësua. Dyqanet u çelën përsëri.